

VLERËSIMI I PERFORMANCËS

SË ANËTARËVE TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE
PËR PERIUDHËN MAJ 2023 - SHKURT 2024

Prizren, Gjilan, Rahovec,
Malishevë, Istog dhe Kllokot



VLERËSIMI I PERFORMANCËS

SË ANËTARËVE TË KUVENDEVE
TË KOMUNAVE PËR PERIUDHËN
MAJ 2023 – SHKURT 2024

Prizren, Gjilan, Rahovec,
Malishevë, Istog dhe Kllokot

Maj, 2024

Ky publikim është bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra dhe Suedia. Përbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e projektit DEMOS/Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo dhe Institutit Demokratik të Kosovës, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Zvicrës dhe Suedisë.

©DEMOS Publikuar: Maj 2024, Prishtinë, Kosovë

Përmbajtja

Qëllimi	5
Metodologjia	5
Performanca e anëtarëve të kuvendit të komunës së Prizrenit	7
<i>Vlerësimi mbi indikatorët</i>	<i>8</i>
Performanca e anëtarëve të kuvendit të komunës së Gjilanit	11
<i>Vlerësimi mbi indikatorët</i>	<i>13</i>
Performanca e anëtarëve të kuvendit të komunës së Rahovecit	16
<i>Vlerësimi mbi indikatorët</i>	<i>17</i>
Performanca e anëtarëve të kuvendit të komunës së Malishevës	21
<i>Vlerësimi mbi indikatorët</i>	<i>22</i>
Performanca e anëtarëve të kuvendit të komunës së Istogut	25
<i>Vlerësimi mbi indikatorët</i>	<i>26</i>
Performanca e anëtarëve të kuvendit të komunës së Klllokotit	29
<i>Vlerësimi mbi indikatorët</i>	<i>30</i>
Rekomandime	33
Databaza	34

Qëllimi

Rritja e llogaridhënies dhe nxitja e një performance më të mirë të anëtarëve të kuvendit komunal në rolin e tyre përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës.

Metodologjia

Me qëllim të matjes së performancës së anëtarëve të kuvendeve të komunave, monitorimi i aktiviteteve ka qenë në formë hibride përkatësisht monitorimi i drejtëpërdrejt (fizikisht) i seancave të kuvendeve të komunave si dhe monitorimi i dëgjimeve buxhetore të organizuara nga ekzekutivi dhe legjislativi i kuvendeve si dhe monitorimi online i aktiviteteve të anëtarëve jashtë seancave të kuvendit të komunës. Anëtarët e kuvendeve të komunave janë vlerësuar në nëntë (9) indikatorë, të ndarë në tri (3) kategori vlerësuese: a) roli përfaqësues b) roli legjislativ/ligjvënës, dhe c) roli mbikëqyrës.

Në rolin përfaqësues, anëtarët e kuvendeve të komunave janë vlerësuar në katër (4) indikatorë:

- #1.1. Numri i takimeve të organizuara nga anëtarët e kuvendit të komunës me përfaqësues të këshillave lokal dhe qytetarë (përfshirë grupet e marginalizuara), për të diskutuar çështjet që janë në interes të komunitetit;
- #1.2. Përqindja e numrit të pjesëmarrësve që i përkasin grupeve të marginalizuara në takimet e organizuara nga anëtarët e kuvendit të komunës (sipas indikatorit 1.1);
- #1.3. Numri i çështjeve/kërkesave që anëtarët e kuvendit komunal kanë ngritur në seanca të Kuvendit Komunal ose i kanë adresuar tek ekzekutivi, e që burojnë nga takimet fizike me qytetarë apo nga komunikimi i anëtarëve të kuvendit komunal me qytetarë përmes rrjeteve sociale;
- #1.4. Përqindja e çështjeve/kërkesave që kanë të bëjnë me interesat e grupeve të marginalizuara të cilat janë ngritur në seancën e kuvendit ose janë adresuar tek ekzekutivi.

Në rolin legjislativ/ligjvënës, anëtarët e kuvendeve të komunave janë vlerësuar në tre (3) indikatorë:

- #2.1. Numri i çështjeve/kërkesave të tjera me interes publik të propozuara nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës të cilat nuk janë të ndërlidhura nga takimet me qytetarë;
- #2.2. Numri i iniciativave ligjore (propozimeve për rregullore komunale, amendamenteve të rregulloreve, vendimeve, buxhetit komunal) që anëtarët e kuvendit komunal kanë ngritur gjatë seancave;
- #2.3. Numri i propozimeve që anëtarët e kuvendit komunal kanë dhënë gjatë dëgjimeve buxhetore për KAB dhe buxhet vjetor të komunës, si në dëgjimet e organizuara nga ekzekutivi ashtu edhe ato të organizuara nga legjislativi i komunës.

Në rolin mbikëqyrës, anëtarët e kuvendeve të komunave janë vlerësuar në dy (2) indikatorë:

#3.1. Numri i pyetjeve dhe kërkesave për raportim që anëtarët e kuvendit komunal i kanë drejtuar anëtarëve të ekzekutivit;

#3.2. Numri i kontratave/projekteve komunale për të cilat anëtarët e kuvendit komunal janë përfshirë fizikisht në mbikëqyrje të zbatimit të tyre.

Periudha e matjes së performancës së anëtarëve ka përfshirë periudhën maj 2023 - shkurt 2024 dhe ka vlerësuar anëtarët e kuvendeve të komunave: Prizren, Gjilan, Rahovec, Malishevë, Istog dhe Kllokot.

Vlerësimi është bërë me pikë dhe pikët maksimale për të gjithë indikatorët ishin 100 pikë. Kryesuesit e kuvendeve të komunave, zëvendës kryesuesi i kuvendit të komunës së Prizrenit nga radhët e komuniteteve si dhe shefat e grupeve të subjekteve politike, nuk kanë qenë pjesë e vlerësimit të performancës me përjashtim të kuvendit të komunës së Kllokotit, ku përjashtohet nga vlerësimi vetëm kryesuesi i kuvendit.

Performanca e anëtarëve të kuvendit të komunës së Prizrenit

Kuvendi i komunës së Prizrenit numëron 41 anëtarë. Opozita në kuvendin e komunës së Prizrenit numëron 29 anëtarë (11 LVV, 6 LDK, 3 AAK, 1 VAKAT, 2 KDTP, 1 NDS, 1 SDU dhe 4 PAVARUR)¹ derisa pozita numëron 12 anëtarë (9 PDK, 2 NISMA dhe 1 YTHP). Nga 41 anëtarë sa numëron kuvendi i komunës së Prizrenit, gjashtë (6) nga ta nuk janë pjesë e vlerësimit bazuar në metodologjinë e matjes së performancës, përfshirë katër (4) shefat e grupeve parlamentare (PDK, LVV, LDK dhe AAK), kryesuesen e kuvendit të komunës dhe kryesuesin e kuvendit nga radhët e komuniteteve.

Nga aspekti i përfaqësimit gjinor, janë 14 anëtare (F) që kanë shënuar performancë pozitive (1 AAK, 2 nga LDK, 4 LVV, 4 PDK, me 1 nga KDTP, NISMA dhe E PAVARUR), derisa janë 21 anëtarë të kuvendit të komunës së Prizrenit (M) që kanë shënuar performancë pozitive (6 nga LVV, 3 nga PDK, 3 nga LDK, 3 të PAVARUR, 1 nga AAK dhe me nga 1 VAKAT, YTHP, SDU, NDS dhe NISMA). Asnjë nga anëtarët e kuvendit të komunës së Prizrenit që kanë qenë pjesë e vlerësimit të performancës gjatë periudhës maj 2023 – shkurt 2024, nuk është vlerësuar me zero pikë, nga fakti se të gjithë anëtarët e kuvendit, në së paku në njërin nga indikatorët vlerësues ka pasur angazhim gjatë kësaj periudhe.

Janë 24 anëtarë nga radhë e opozitës në kuvendin e komunës së Prizrenit të cilët janë pjesë e vlerësimit të performancës (LVV, LDK, VAKAT, KDTP, NDS dhe 4 PAVARUR)² derisa pozita numëron 11 anëtarë të cilët janë pjesë e vlerësimit të performancës (PDK, NISMA, SDU, YTHP). Nga 24 anëtarë të opozitës, të gjithë kanë treguar angazhim/performancë (9 F dhe 15 M). Edhe 11 anëtarët e kuvendit të komunës nga radhët e pozitës, gjatë periudhës vlerësuese kanë treguar angazhim/performancë në së paku njërin indikator (5 F dhe 6 M).

Gjatë periudhës maj 2023 – shkurt 2024, janë 35 anëtarë që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues. Petrit Hoxhaj (PAVARUR) është anëtari që ka performuar më së miri gjatë kësaj periudhe me 65 pikë, Ilir Gashi (LVV) me 55 pikë dhe Dafina Alishani (LVV) me 50 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

Anëtarët që kanë performuar më dobët gjatë kësaj periudhe janë: Agnesa Sinanaj – Gavazaj (AAK), Brikena Karavidaj (LDK), Shkelzen Kastrati (PDK). Këta janë anëtarët të cilët gjatë kësaj periudhe kanë arritur të vlerësohen me vetëm 2 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

1 Zyrarisht këto subjekte politike nuk kanë koalicion me partinë në pushtet derisa Kujtesa Kabashi – Shatri mandatin e ka fituar përmes subjektit politik LDK, por është deklaruar si e pavarur; Bujar Hasani dhe Kastriot Krasniqi janë deklaruar si të pavarur, por mandatin e kanë fituar përmes subjektit politik PDK, si dhe Petrit Hoxhaj është deklaruar si i pavarur, por mandatin e ka fituar përmes LVV-së.

2 Zyrarisht këto subjekte politike nuk kanë koalicion me partinë në pushtet.

Anëtarët (F) që kanë përformuar më së miri gjatë kësaj periudhe janë: Dafina Alishani (LVV) me 50 pikë, Egzona Hoxhaj (PDK) me 40 pikë dhe Ymran Fusha (PDK) me 35 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

Nga aspekti i përfaqësimit të subjekteve politike, të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës së Prizrenit të përfaqësuar nga subjektet e ndryshme politike janë vlerësuar pozitivisht dhe ndër ta janë dhjetë (10) anëtarë nga LVV, 7 nga PDK, 5 nga LDK, 2 nga AAK, 2 NISMA, me nga një anëtarë nga KDTP, VAKAT, YTHP, SDU, NDS si dhe 4 të Pavarur.

Janë 19 anëtarë të kuvendit të komunës që për herë të parë kanë marrë mandatin për ti përfaqësuar qytetarët në këtë institucion. Ne aspektin gjinor në këtë kategori, janë 6 anëtare (F) dhe 13 anëtarë (M), të cilët kanë fituar mandatin për herë të parë. Megjithëse të gjithë nga këta anëtarë kanë treguar rezultate pozitive në së paku njërin nga indikatorët vlerësues, janë gjashtë (6) anëtarë në këtë kategori të cilët kanë performuar më mirë. Në mesin e këtyre anëtarëve që kanë performuar më mirë në këtë kategori janë: Egzona Hoxhaj (PDK) me 40 pikë, Selman Sokolaj (LVV) me 35 pikë, Ymran Fusha (PDK) me 35 pikë, Islam Thaqi (LVV) me 30 pikë, Marin Përgjoka (LDK) me 25 pikë dhe Sead Arifi (VAKAT) me 23 pikë.

Sa i përket klasifikimit të moshës, kuvendi i komunës së Prizrenit numëron 8 anëtarë nga moshe 18-35. Në mesin e tyre, të gjithë anëtarët kanë treguar performancë derisa anëtarja Dafina Alishani (LVV) është anëtarja që ka performuar më së miri në këtë grup moshë me gjithsej 50 pikë, e ndjekur nga Egzona Hoxhaj (PDK) me 40 pikë dhe Marin Përgjoka (LDK) me gjithsej 25 pikë. Ne aspektin gjinor në këtë grup moshë, janë 4 anëtare (F) dhe 4 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë.

Kuvendi i komunës së Prizrenit numëron 19 anëtarë, mosha e të cilëve është nga 36 deri 50 vjet. Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës së Prizrenit në këtë grup moshë kanë treguar angazhim performancë dhe asnjë prej tyre nuk është vlerësuar me zero pikë. Anëtari i kuvendit të komunës Petrit Hoxhaj (Pavarur) është anëtari që ka performuar më së miri në këtë grup moshë me gjithsej 65 pikë, i ndjekur nga Selman Sokolaj (LVV) me 35 pikë. Në aspektin gjinor në këtë grup moshë, janë 8 anëtare (F) dhe 11 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë.

Kuvendi i komunës së Prizrenit numëron 8 anëtarë, mosha e të cilëve është nga 51 e tutje. Edhe në këtë grup moshë, të gjithë anëtarët treguan angazhim/performancë dhe asnjë prej tyre nuk është vlerësuar me zero pikë. Anëtari i kuvendit të komunës Ilir Gashi (LVV) është anëtari që ka performuar më së miri në këtë grup moshë me gjithsej 55 pikë, pasur nga Ymran Fusha (PDK) me 35 pikë si dhe Islam Thaqi (LVV) dhe Shukri Quni (NISMA) me nga 30 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në të gjithë indikatorët. Ne aspektin gjinor në këtë grup moshë, janë 2 anëtare (F) dhe 6 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë.

Vlerësimi mbi indikatorët

Sa i përket indikatorit vlerësues, 1.1 **“Numri i takimeve të organizuara nga anëtarët e kuvendit të komunës me këshillat lokal, qytetarët dhe grupet e marginalizuara”** gjatë periudhës vlerësuese janë tre anëtarë të kuvendit të komunës së Prizrenit të cilët kanë organizuar takime me qytetarë. Ilir Gashi (LVV), Petrit Hoxhaj (PAVARUR) dhe Egzona Hoxhaj (PDK), gjatë kësaj periudhe vlerësuese kanë organizuar nga dy (2) takime me qytetarë.

Sa i përket indikatorit vlerësues, 1.2 **“Numri i pjesëmarrësve në takimet e organizuara që i përkasin grupeve të marginalizuara”**, Petrit Hoxhaj (PAVARUR) dhe Egzona Hoxhaj (PDK), janë të vetmit këta dy anëtarë të cilët edhe janë vlerësuar në indikatorin 1.2 me nga pesë (5) pikë për shkak të numrit të pjesëmarrjes së grupeve të marginalizuara në takimet e organizuara gjatë periudhës maj 2023 – shkurt 2024. Sa i përket angazhimit pozitiv – opozitiv, dy nga këta anëtarë vijnë nga radhët e opozitës (LVV dhe Pavarur) dhe një (1) anëtarë që ka organizuar takime me qytetarë vjen nga radhët e pozitës (PDK).

Lidhur me indikatorin 1.3 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave të ngritura nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës që rrjedhin nga takimet me qytetarë dhe ndërveprimet me mediat sociale”**, gjatë kësaj periudhe vlerësuese maj 2023 – shkurt 2024, janë dymbëdhjetë (12) anëtarë të cilët kanë shënuar angazhim/performancë. Dhjetë(10) anëtarë të cilët kanë treguar rezultat në këtë indikator vijnë nga radhët e opozitës (6 LVV, 2 LDK dhe 2 PAVARUR) dhe dy (2) nga radhët e pozitës (PDK). Në aspektin gjinor, në këtë indikator kanë treguar performancë gjashtë (6) anëtare (F) dhe pesë (5) anëtarë (M). Numrin më të madh të çështjeve/kërkesave në këtë indikator e ka ngritur Ilir Gashi (LVV) me gjithsej 7 çështje/kërkesa dhe është vlerësuar me 10 pikë sa është edhe maksimalja e vlerësimit në këtë indikator. Petrit Hoxhaj (PAVARUR) dhe Nazife Kokollari (LVV) kanë ngritur nga dy (2) çështje/kërkesa në këtë indikator dhe anëtarët e tjerë Dafina Alishani (LVV), Islam Thaci (LVV), Selman Sokolaj (LVV), Faruk Tahiri (LVV), Naxhije Memaj (LDK), Qemajl Krasniqi (LDK), Dafina Bllaca (PDK), Egzona Hoxhaj (PDK) dhe Kujtesa Kabashi – Shatri (Pavarur) janë anëtarët të cilët kanë ngritur nga një (1) çështje apo kërkesë dhe si rezultat i kësaj janë vlerësuar me nga pesë (5) pikë. Në anën tjetër, janë plot 23 anëtarë të kuvendit të komunës së Prizrenit, të cilët janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator vlerësues.

Lidhur me indikatorin 1.4 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave që kanë të bëjnë me interesin e Grupeve të Margjinalizuara të cilat janë ngritur në seancën e kuvendit”**, gjatë kësaj periudhe janë katër (4) anëtarë që kanë shënuar rezultat pozitiv. Dafina Alishani (LVV) me 5 pikë, Islam Thaqi (LVV) me 5 pikë Egzona Hoxhaj (PDK) me 5 pikë dhe Naxhije Memaj (LDK) me 5 pikë, tre nga radhët e opozitës dhe një nga rradhët e pozitës. Në anën tjetër, janë gjithsej 31 anëtarë të kuvendit të komunës së Prizrenit, të cilët janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator vlerësues.

Lidhur me indikatorin 2.1 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave të tjera me interes publik të propozuara nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës të cilat nuk janë të ndërlidhura nga takimet me qytetarë”**, gjatë periudhës vlerësuese maj 2023 deri shkurt 2024, tre (3) anëtarë të kuvendit të komunës nuk kanë ngritur ndonjë çështje dhe si rezultat janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Nazife Kokollari (LVV), Kastriot Krasniqi (PAVARUR) dhe Driton Daçi (PDK), janë anëtarët të cilët nuk kanë ngritur asnjë çështje apo kërkesë gjatë kësaj periudhë të vlerësimit dhe janë vlerësuar me zero (0) pikë në këtë indikator.

Në anën tjetër janë 32 anëtarë të kuvendit të komunës së Prizrenit të cilët kanë ngritur çështje apo kërkesa gjatë seancave të mbajtura gjatë periudhës vlerësuese. Në mesin e 32 anëtarëve që kanë treguar performancë, 22 prej tyre janë nga radhët e opozitës (9 LVV, 5 LDK, 2 AAK, 1 KDTP, 1 VAKAT, 1 NDS dhe 3 PAVARUR) dhe 10 nga radhët e pozitës (6 PDK, 2 NISMA, 1 SDU dhe 1 YTHP). Në aspektin gjinor, janë 13 anëtare (F) dhe 19 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë në këtë indikator. Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, janë 13 anëtarë të kuvendit të komunës që janë vlerësuar me pesë (5) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit nga fakti se kanë ngritur më shumë se shtatë (7) çështje apo kërkesave gjatë periudhës vlerësuese. Ndërsa anëtarët që kanë ngritur numrin më të madh të çështjeve gjatë kësaj periudhë vlerësuese janë: Ilir Gashi (LVV) me gjithsej 21 çështje të ngritura, Dafina Alishani (LVV) me gjithsej 18 çështje të ngritura dhe Ymran Fusha (PDK) me gjithsej 15 çështje të ngritura. Në total, janë ngritur gjithsej 224 çështje të ndryshme nga anëtarët e kuvendit të komunës së Prizrenit gjatë kësaj periudhe vlerësuese derisa çështjet e tilla të ngritura gjatë kësaj periudhe kryesisht prinin ato të karakterit infrastrukturor (rrugë, kanalizim, ndriçim etj.)

Lidhur me indikatorin 2.2 përkatësisht **“Numri i iniciativave legjislative (rregulloret komunale, propozimet për amendamentim të rregulloreve, buxheti) të propozuara nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës së kuvendit”**, gjatë periudhës vlerësuese maj 2023 – shkurt 2024, Ilir Gashi (LVV) ka propozuar katër (4) iniciativa ligjore, Dafina Alishani (LVV) ka qenë anëtarja që ka propozuar tri (3) iniciativa ligjore, Marin Përgjoka (LDK), Petrit Hoxhaj (PAVARUR), Agim Muçaj (AAK) dhe Ertan Simitci (YTHP) kanë propozuar nga një (1) iniciativë ligjore.

Lidhur me indikatorin 2.3 përkatësisht **“Numri propozimeve gjatë zhvillimit të dëgjimeve buxhetore për KAB dhe projekt buxhetin e komunës të organizuara nga ekzekutivi dhe legjislativi”**, gjatë monitorimit të dëgjimeve buxhetore për KAB dhe projekt buxhetin e komunës, janë 26 anëtarë të cilët nuk kanë dhënë asnjë propozim për projekt buxhetin e komunës gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore.

Nëntë (9) anëtarë janë vlerësuar pozitivisht në këtë indikator për shkak të dhënies së propozimeve për projekt buxhet gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore. Në mesin e 9 anëtarëve, 4 prej tyre ishin nga radhët e opozitës (1 VAKAT, 2 PAVARUR, 1 LDK) dhe 5 nga radhët e pozitës (2 PDK, 2 NISMA dhe 1 YTAP). Përfaqësimi gjinor në këtë indikator vlerësues është 4 (F) me 5 (M). Numrin më të madh të propozimeve gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore e ka dhënë Ymran Fusha (PDK) me gjithsej 12 propozime duke arritur vlerësimin maksimal në këtë indikator me 15 pikë, pasuar nga Marin Përgjoka (LDK) me 10 propozime, Shukri Quni me 8 propozime dhe Petrit Hoxhaj (PAVARUR) me 6 propozime, duke u vlerësuar me nga 10 pikë nga 15 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në këtë indikator. Anëtarët e tjerë që kanë dhënë propozime për buxhet gjatë zhvillimit të dëgjimeve buxhetore dhe që kanë arritur të vlerësohen me nga pesë (5) pikë nga 15 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në këtë indikator janë: Egzona Hoxha (PDK), Shukrije Berisha (NISMA), Sead Arifi (VAKAT), Ertan Simitci (YTHP) si dhe Kujtesa Kabashi – Shatri (Pavarur). Vlen të ceket se 26 anëtarë të kuvendit të komunës, gjatë kësaj periudhe vlerësuese janë vlerësues me zero (0) pikë në këtë indikator, për shkak të mos angazhimit në dhënien e propozimeve gjatë zhvillimit të dëgjimeve buxhetore për KAB si dhe projekt buxhetin e komunës.

Lidhur me indikatorin 3.1 përkatësisht **“Numri i pyetjeve dhe kërkesave për raportim drejtuar anëtarëve të ekzekutivit”**, gjatë periudhës vlerësuese maj 2023 - shkurt 2024, janë 27 anëtarë të kuvendit të komunës së Prizrenit të cilët kanë treguar performancë në këtë indikator. Nga 27 anëtarë që kanë treguar performancë, 19 prej tyre janë nga radhët e opozitës (8 LVV, 4 LDK, 1 AAK, 1 VAKAT, 1 NDS, 1 KDTP dhe 3 PAVARUR,) dhe 8 nga radhët e pozitës (4 PDK, 2 NISMA, 1 YHTP dhe 1 SDU). Në aspektin gjinor, janë 9 anëtare (F) dhe 18 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë në këtë indikator. Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, janë 6 anëtarë të kuvendit të komunës që janë vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit nga fakti se kanë ngritur më shumë se dhjetë (10) pyetje gjatë periudhës vlerësuese. Ndërsa anëtarët që kanë ngritur numrin më të madh të çështjeve gjatë kësaj periudhë vlerësuese janë: Dafina Alishani (LVV) me gjithsej 32 pyetje të ngritura, Ilir Gashi (LVV) me gjithsej 26 pyetje të ngritura dhe Petrit Hoxhaj (PAVARUR) me 20 pyetje të ngritura. Në total, janë ngritur gjithsej 202 pyetje të ndryshme nga anëtarët e kuvendit të komunës së Prizrenit gjatë kësaj periudhe vlerësuese derisa pyetjet e tilla të ngritura gjatë kësaj periudhe kryesisht prinin ato të karakterit infrastrukturor (rrugë, kanalizim, trotuare, ndriçim etj.)

Lidhur me indikatorin 3.2 përkatësisht **“Numri i kontratave/projekteve të cilat anëtarët e kuvendit të komunës janë përfshirë fizikisht në mbikëqyrje të zbatimit”**, janë katërmbëdhjetë (14) anëtarë të cilët kanë treguar performancë në këtë indikator, ku dhjetë (10) prej tyre nga radhët e opozitës (6 LVV, 1 VAKAT dhe 3 PAVARUR) dhe katër (4) prej tyre nga radhët e pozitës (3 PDK dhe 1 SDU). Sa i përket aspektit gjinor, 9 janë anëtarë (M) dhe 5 te tjerë janë anëtare (F).

Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, janë 5 anëtarë të kuvendit të komunës që janë vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit në këtë indikator nga fakti se kanë mbikëqyrur më shumë se dhjetë (10) projekte të ndryshme. Në mesin e anëtarëve që kanë mbikëqyrur më shumë projekte janë: Ilir Gashi (LVV) me gjithsej 46 projekte të mbikëqyrura, Selman Sokolaj (LVV) me gjithsej 41 projekte të mbikëqyrura dhe Petrit Hoxhaj (PAVARUR) me gjithsej 26 projekte të mbikëqyrura gjatë periudhës vlerësuese.

Performanca e anëtarëve të kuvendit të komunës së Gjilanit

Kuvendi i komunës së Gjilanit numëron 35 anëtarë. Në kuptim të konfigurimit politik shumicën e Kuvendit Komunal e përbëjnë partitë opozitare në krye me LDK, PDK, AAK, Lëvizja Vatra dhe Lista Serbe, kurse në pozitë përfshihen Lëvizja Vetëvendosje që qeverisë me Gjilanin, ku ka mbështetje në Kuvend nga partitë KDTP dhe AKR. Nga 35 anëtarë sa numëron kuvendi i komunës së Gjilanit, katër nga ta nuk janë pjesë e vlerësimit bazuar në metodologjinë e matjes së performancës, përfshirë tre (3) shefat e grupeve parlamentare (LVV, LDK dhe PDK) si dhe kryesuesin e kuvendit të komunës. Ish kryesuesi i kuvendit të komunës së Gjilanit, Arianit Sadiku, është përfshirë në vlerësim të performancës që nga seanca e shkarkimit të tij³

Vlen të theksohet se me ekzekutivin e Gjilanit udhëheq Lëvizja Vetëvendosje, mirëpo në kuvendin e komunës nuk e gëzon shumicën si dhe pas prishjes së koalicionit ndërmjet VV dhe PDK është zgjedhur kryesuesi i ri i kuvendit të komunës nga radhët e Levizjes Vatra. Opozitë e deklaruar në kuvendin e komunës së Gjilanit janë LDK, PDK dhe AAK, Lista Serbe derisa AKR dhe partia turke KDTP e mbështetin Lëvizjen Vetëvendosje në kuvend.

Gjatë periudhës maj 2023 - shkurt 2024, janë 27 anëtarë të kuvendit të komunës së Gjilanit që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues. Në mesin e anëtarëve që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues, nga radhët e pozitës janë 8 anëtarë (8 LVV) dhe nga radhët e opozitës janë 19 anëtarë (13 LDK, 3 PDK, 2 AAK dhe 1 Lista Serbe). Në aspektin gjinor, janë 9 anëtare (F) të kuvendit të komunës së Gjilanit të cilat kanë shënuar performancë (5 nga LDK, 2 nga LVV, 1 nga PDK dhe 1 nga AAK) derisa janë 18 anëtarë (M) të kuvendit të komunës që kanë shënuar performancë pozitive (8 nga LDK, 6 nga LVV, 2 nga PDK, 1 AAK dhe 1 nga L.Serbe). Janë katër (4) anëtarë të kuvendit të komunës së Gjilanit, të cilët gjatë periudhës së vlerësimit maj 2023 – shkurt 2024 nuk kanë shënuar asnjë rezultat në asnjë nga indikatorët vlerësues dhe janë vlerësuar me zero pikë. Në mesin e anëtarëve që nuk kanë shënuar asnjë rezultat, 3 janë nga radhët e pozitës (1 LVV, 1 KDTP dhe 1 AKR) dhe një (1) nga radhët e opozitës (PDK). Në aspektin gjinor, janë 2 anëtare (F) dhe 2 anëtarë (M) të cilët nuk kanë shënuar asnjë rezultat gjatë periudhës së vlerësimit.

Në mesin e 27 anëtarëve që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues, anëtarët e kuvendit të komunës të cilët kanë shënuar rezultate më të larta gjatë periudhës së vlerësimit janë: Gentrit Murseli (LDK) me 79 pikë, Besnik Shala (LVV) me 65 pikë, Blerim Haziri (LVV) me 62 pikë dhe Gresa Avdiu (LDK) me nga 57 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

3 Shkarkimi është bërë më 30 qershor 2023

Anëtarët që kanë performuar më dobët gjatë kësaj periudhe janë: Besim Guda (LDK) me dy (2) pikë, Drenusha Maloku (LDK) me pesë (5) pikë, Teuta Suliqi (LDK) me 5 pikë, Ardita Ukshini (AAK) me pesë (5) pikë dhe Sreten Trajkovic (L.Serbe) me pesë (5) pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët. Anëtarët që nuk kanë performuar gjatë kësaj periudhe dhe janë vlerësuar me zero (0) pikë janë: Valdrin Bajrami (LVV), Erestina Isufi (PDK), Emrah Ismaili (KDTP) dhe Sebahate Hajdini (AKR).

Anëtarët (F) e kuvendit të komunës së Gjilanit që kanë performuar më së miri gjatë kësaj periudhe janë: Gresa Avdiu (LDK) me 57 pikë, Ardhmërie Jakupi – Musliu (LVV) me 23 pikë dhe Mimoza Kadriu – Qerimi (LVV) me 22 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

Janë 18 anëtarë të kuvendit të komunës që për herë të parë kanë marrë mandatin për ti përfaqësuar qytetarët në këtë institucion. Ne aspektin gjinor në këtë kategori, janë 7 anëtare (F) dhe 11 anëtarë (M), të cilët kanë fituar mandatin për herë të parë.

Pesëmbëdhjetë (15) anëtarë të kuvendit të komunës kanë treguar rezultate pozitive në së paku njërin nga indikatorët vlerësues (5 LVV, 5 LDK, 3 PDK, 1 AAK, 1 L.Serbe) mirëpo anëtarët që kanë treguar performancë më të mirë në kategorinë e përfaqësimit të qytetarëve në mandatin e parë janë: Besnik Shala (LVV) me 65 pikë, Blerim Haziri (LVV) me 62 pikë, Gresa Avdiu (LDK) me 57 pikë, dhe Imran Haziri me 50 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët. Ne aspektin gjinor në këtë kategori, kanë rezultat pesë (5) anëtare (F) dhe dhjetë (10) anëtarë (M) të kuvendit të komunës.

Në anën tjetër, janë tre anëtarë në këtë kategori të cilët nuk kanë shënuar asnjë rezultat gjatë periudhës së vlerësimit dhe janë vlerësuar me zero (0) pikë: Valdrin Bajrami (LVV), Erestina Isufi (PDK) dhe Sebahate Hajdini (AKR). Ne aspektin gjinor në këtë kategori, nuk kanë dhanë rezultat dy (2) anëtare (F) dhe një (1) anëtar (M) i kuvendit të komunës.

Sa i përket klasifikimit të moshës, kuvendi i komunës së Gjilanit numëron 8 anëtarë nga moshe 18-35. Në mesin e tyre, gjashtë (6) kanë treguar performancë dhe dy (2) nuk kanë treguar performancë gjatë kësaj periudhe të vlerësimit. Anëtari Gentrit Murseli (LDK) është anëtari që ka performuar më së miri në këtë grup moshë me gjithsej 79 pikë, i ndjekur nga Gresa Avdiu (LDK) me gjithsej 57 pikë dhe Imran Haziri (LDK) me 50 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët. Ne aspektin gjinor në këtë grup moshë, janë 3 anëtare (F) dhe 3 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë. Anëtarët që nuk kanë shënuar asnjë rezultat në këtë grup moshë janë: Erestina Isufi (PDK) dhe Emrah Ismail (KDTP).

Kuvendi i komunës së Gjilanit numëron 11 anëtarë, mosha e të cilëve është nga 36 deri 50 vjet. Shtatë (7) nga anëtarët e kuvendit të komunës së Gjilanit në këtë grup moshë kanë treguar angazhim/performancë dhe një (1) prej tyre është vlerësuar me zero pikë. Anëtari i kuvendit të komunës Besnik Shala (LVV) është anëtari që ka performuar më së miri në këtë grup moshë me gjithsej 65 pikë, i ndjekur nga Blerim Haziri (LVV) me 62 pikë dhe Muhedin Haziri (LDK) me 30 pikë. Ne aspektin gjinor në këtë grup moshë, janë 4 anëtare (F) dhe 6 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë. Anëtari i kuvendit të komunës i cili nuk ka shënuar performancë në këtë grup moshë është Valdrin Bajrami (LVV).

Kuvendi i komunës së Gjilanit numëron 12 anëtarë, mosha e të cilëve është nga 51 e tutje. Edhe në këtë grup moshë, 11 anëtarë treguan angazhim/performancë dhe një (1) prej tyre është vlerësuar me zero pikë. Anëtari i kuvendit të komunës Ismail Kurteshi (LVV) është anëtari që ka performuar më së miri në këtë grup moshë me gjithsej 48 pikë, pasuar nga Nazim Gagica (AAK) me 30 pikë, Latif Maliqi (LDK) me 28 pikë dhe Sami Ahmeti (LDK) me 27 pikë, nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në gjithë indikatorët. Në aspektin gjinor në këtë grup moshë, janë 2 anëtare (F) dhe 9 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë. Anëtarja e kuvendit të komunës e cila nuk ka shënuar performancë në këtë grup moshë është Sebahate Hajdini (AKR).

Vlerësimi mbi indikatorët

Sa i përket indikatorëve vlerësues 1.1 **“Numri i takimeve të organizuara nga anëtarët e kuvendit të komunës me këshillat lokal, qytetarët dhe grupet e marginalizuara”**, gjatë periudhës vlerësuese janë 12 anëtarë të kuvendit të komunës së Gjilanit të cilët kanë organizuar takime me qytetarë, në total prej 49 takime me qytetarë. Gentrin Murseli (LDK) dhe Gresa Avdiu (LDK), gjatë kësaj periudhe janë vlerësuar me nga 15 pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit për shkak të numrit të madh të organizimit të takimeve me qytetarë. Anëtarë të tjerë të cilët kanë organizuar takime me qytetarë dhe janë vlerësuar me 5 pikë janë: Arbër Musliu (LVV), Ardhmërie Jakupi – Musliu (LVV), Besnik Shala (LVV), Blerim Haziri (LVV), Ismajl Kurteshi (LVV), Laurant Shabani (LVV), Mimoza Kadriu – Qerimi (LVV), Imran Haziri (LDK), Sami Ahmeti (LDK) dhe Ardita Ukshini (AAK). Në kuadër të 48 organizimeve të tilla, janë identifikuar edhe pjesëmarrja e qytetarëve që i përkasin grupeve të marginalizuara andaj anëtarët që kanë shënuar performancë në indikatorin 1.2 përkatësisht në **“Numri i pjesëmarrësve në takimet e organizuara që i përkasin grupeve të marginalizuara”** janë të gjithë pos Sami Ahmeti (LDK), ku në takimin e organizuar me qytetarë nuk janë identifikuar pjesëmarrës nga grupet e marginalizuara dhe nga ky shkak nuk ka arritur të vlerësohet në indikatorin 1.2. Sa i përket angazhimit pozitiv – opozitë, shtatë nga këta anëtarë vijnë nga radhët e pozitës (7 LVV) dhe pesë (5) anëtare që kanë organizuar takime me qytetarë janë nga radhët e opozitës (4 LDK, 1 AAK).

Lidhur me indikatorin 1.3 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave të ngritura nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës që rrjedhin nga takimet me qytetarë dhe ndërveprimet me mediat sociale”**, gjatë kësaj periudhe vlerësuese maj 2023 – shkurt 2024, janë tetë (8) anëtarë të cilët kanë shënuar angazhim/performancë. Pesë (5) anëtarë të cilët kanë treguar rezultat në këtë indikator janë nga radhët e opozitës (3 LDK, 1 PDK dhe 1 AAK) dhe tre (3) nga radhët e pozitës (3 LVV). Në aspektin gjinor, në këtë indikator kanë treguar performancë tetë (8) anëtarë (M) dhe asnjë anëtare (F) e kuvendit nuk ka treguar performancë në këtë indikator. Numrin më të madh të çështjeve/kërkesave në këtë indikator e ka ngritur Gentrin Murseli (LDK) me gjithsej 16 çështje/kërkesa dhe është i vetmi anëtar i cilët është vlerësuar me 15 pikë sa është edhe maksimalja e vlerësimit në këtë indikator. Anëtarë i kuvendit të komunës Blerim Haziri (LVV) gjatë periudhës së vlerësimit ka ngritur 8 çështje/kërkesa, Besnik Shala (LVV) ka ngritur 6 çështje/kërkesa që rrjedhin nga takimet apo ndërveprimet me mediat sociale dhe janë vlerësuar me 10 pikë nga 15 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në këtë indikator. Anëtarët të cilët kanë ngritur çështje/kërkesa që rrjedhin nga takimet me qytetarë apo ndërveprimet sociale janë: Imran Haziri (LDK) dhe Faton Milazimi (PDK) me nga 3 çështje/kërkesa, Ismajl Kurteshi (LVV) me 2 çështje/kërkesa, Muhedin Haziri (LDK) dhe Nazim Gagica (AAK) me nga 1 çështje/kërkesë dhe të gjithë këta anëtarë janë vlerësuar me pesë (5) pikë nga 15 pikë sa është edhe maksimalja e vlerësimit në këtë indikator. Në anën tjetër, janë 23 anëtarë të kuvendit të komunës së Gjilanit, të cilët janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator vlerësues.

Indikatorin 1.4 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave që kanë të bëjnë me interesin e Grupeve të Margjinalizuara të cilat janë ngritur në seancën e kuvendit”**, gjatë kësaj periudhe janë dy anëtarë që kanë shënuar rezultat pozitiv, Besnik Shala (LVV) me tri (3) pikë dhe Gentrin Murseli (LDK) me dy (2) pikë nga 5 pikë sa është maksimalja në këtë indikator. Në anën tjetër, janë 29 anëtarë të kuvendit të komunës së Gjilanit, të cilët janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator vlerësues.

Lidhur me indikatorin 2.1 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave të tjera me interes publik të propozuara nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës të cilat nuk janë të ndërlidhura nga takimet me qytetarë”**, gjatë periudhës vlerësuese maj 2023 deri shkurt 2024, janë dhjetë (10) anëtarë të kuvendit të komunës që nuk kanë ngritur ndonjë çështje dhe si rezultat janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Pesë (5) nga ta vijnë nga radhët e pozitës (3 LVV, 1 KDTP dhe 1 AKR) dhe pesë (5) nga radhët e opozitës (2 LDK, 1 PDK, 1 AAK dhe 1 L.Serbe).

Në anën tjetër janë 21 anëtarë të kuvendit të komunës së Gjilanit të cilët kanë ngritur çështje apo kërkesa gjatë seancave të mbajtura gjatë periudhës vlerësuese. Në mesin e 21 anëtarëve që kanë treguar performancë, 6 prej tyre janë nga radhët e pozitës (6 LVV) dhe 15 nga radhët e opozitës (11 LDK, 3 PDK dhe 1 AAK). Në aspektin gjinor, janë 5 anëtare (F) dhe 16 anëtarë (M) që kanë shënuar

performancë në këtë indikator. Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, janë 6 anëtarë të kuvendit të komunës që janë vlerësuar me pesë (5) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit nga fakti se kanë ngritur më shumë se shtatë (7) çështje apo kërkesa gjatë periudhës vlerësuese.

Ndërsa anëtarët që kanë ngritur numrin më të madh të çështjeve gjatë kësaj periudhë vlerësuese janë: Muhedin Haziri (LDK) me gjithsej 20 çështje të ngritura, Ismajl Kurteshi (LVV) me gjithsej 19 çështje të ngritura, Gentrit Murseli (LDK) me gjithsej 18 çështje të ngritura, Imran Haziri (LDK) me gjithsej 11 çështje të ngritura dhe Nazim Gagica (AAK) me 9 çështje të ngritura. Në total, janë ngritur gjithsej 128 çështje të ndryshme nga anëtarët e kuvendit të komunës së Gjilanit gjatë kësaj periudhe vlerësuese derisa çështjet e tilla të ngritura gjatë kësaj periudhe kryesisht prinin ato të karakterit infrastrukturor (rrugë, kanalizim, ndriçim etj.)

Lidhur me indikatorin 2.2 përkatësisht **“Numri i iniciativave legislative (rregulloret komunale, propozimet për amendamentim të rregulloreve, buxheti) të propozuara nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës së kuvendit”**, gjatë periudhës maj 2023 - shkurt 2024, janë 15 anëtarë të kuvendit të komunës së Gjilanit të cilët kanë treguar performancë në këtë indikator. Në mesin e tyre, shtatë (7) vijnë nga radhët e pozitës (LVV) dhe 8 nga radhët e opozitës (7 LDK dhe 1 AAK). Në aspektin gjinor, janë katër (4) anëtare (F) dhe njëmbëdhjetë (11) anëtarë (M) të kuvendit të komunës që kanë treguar performancë.

Ismajl Kurteshi (LVV) ka qenë anëtari i kuvendit të komunës i cili gjatë periudhës vlerësuese është vlerësuar me pikë maksimale përkatësisht me 10 pikë për shkak të propozimit të 14 iniciativave ligjore. Gentrit Murseli (LDK) gjatë kësaj periudhe ka propozuar 10 iniciativa ligjore dhe merr shtatë (7) pikë, Gresa Avdiu (LDK), Latif Maliqi (LDK), Sami Ahmeti (LDK) janë anëtarët e kuvendit të komunës që kanë propozuar nga 4 iniciativa ligjore, Ardhmërie Jakupi Musliu (LVV), Blerim Haziri (LVV), Besnik Shala (LVV), Mimoza Kadriu Qerimi (LVV), Imran Haziri (LDK), Nazim Gagica (AAK), janë anëtarët e kuvendit të komunës që kanë propozuar nga 3 iniciativa ligjore, Shpresa Kurtishi Emini (LDK) ka propozuar 2 iniciativa ligjore, Arianit Sadiku (LVV), Arber Musliu (LVV) dhe Muhedin Haziri (LDK) kanë propozuar nga një (1) iniciativë ligjore dhe si rezultat i propozimeve të tilla, këta anëtarë janë vlerësuar me nga pesë (5) pikë nga 10 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për këtë indikator.

Lidhur me indikatorin 2.3 përkatësisht **“Numri propozimeve gjatë zhvillimit të dëgjimeve buxhetore për KAB dhe projekt buxhetin e komunës të organizuara nga ekzekutivi dhe legjislativi”**, gjatë monitorimit të dëgjimeve buxhetore për KAB dhe projekt buxhetin e komunës, janë 26 anëtarë të cilët nuk kanë dhënë asnjë propozim për projekt buxhetin e komunës gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore. Pesë (5) anëtarë janë vlerësuar pozitivisht në këtë indikator për shkak të dhënies së propozimeve për projekt buxhet gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore. Në mesin e 5 anëtarëve, 3 prej tyre vijnë nga radhët e opozitës (2 LDK dhe 1 AAK) dhe 2 nga radhët e pozitës (2 LVV). Përfaqësimi gjinor në këtë indikator vlerësues ishte 0 (F) me 5 (M).

Numrin më të madh të propozimeve gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore e ka dhënë Blerim Haziri (LVV) me gjithsej 13 propozime duke arritur vlerësimin maksimal në këtë indikator me 15 pikë, pasuar nga Besnik Shala (LVV) dhe Ekrem Kryeziu (PDK) me nga 10 propozime dhe janë vlerësuar me 10 pikë. Numër më të vogël të propozimeve për buxhet ka dhënë Sami Ahmeti (LDK) me dy (2) propozime si dhe Muhedin Haziri (LDK) me një (1) propozim dhe janë vlerësuar me nga pesë (5) pikë nga pesëmbëdhjetë (15) pikë sa është maksimalja e vlerësimit për këtë indikator. Vlen të ceket se 26 anëtarë të kuvendit të komunës, gjatë kësaj periudhe vlerësuese janë vlerësuar me zero (0) pikë në këtë indikator, për shkak të mos angazhimit në dhënien e propozimeve gjatë zhvillimit të dëgjimeve buxhetore për KAB si dhe projekt buxhetin e komunës.

Lidhur me indikatorin 3.1 përkatësisht **“Numri i pyetjeve dhe kërkesave për raportim drejtuar anëtarëve të ekzekutivit”**, gjatë periudhës vlerësuese maj 2023 - shkurt 2024, janë 23 anëtarë të kuvendit të komunës së Gjilanit të cilët kanë treguar performancë në këtë indikator. Nga 23 anëtarë që kanë treguar performancë, 16 prej tyre janë nga radhët e opozitës (12 LDK, 2 PDK, 1 AAK, 1 L.Serbe) dhe 7 nga radhët e pozitës (7 LVV). Në aspektin gjinor, janë 8 anëtare (F) dhe 15 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë në këtë indikator.

Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, janë nëntë (9) anëtarë të kuvendit të komunës që janë vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit nga fakti se kanë ngritur më shumë se dhjetë (10) pyetje gjatë periudhës vlerësuese. Pra, anëtarët që kanë ngritur numrin më të madh të pyetjeve gjatë kësaj periudhë vlerësuese janë: Gresa Avdiu (LDK) me gjithsej 63 pyetje të ngritura, Imran Haziri (LVV) me gjithsej 25 pyetje të ngritura, Gentrin Murseli (LDK) dhe Afërdita Balaj (LDK) me nga 23 pyetje të ngritura, Sami Ahmeti (LDK) me 20 pyetje të ngritura, Latif Maliqi (LDK) dhe Ismajl Kurteshi me nga 14 pyetje të ngritura, Ekrem Kryeziu (PDK) dhe Nazim Gagica me nga 12 pyetje të ngritura si dhe Muhedin Haziri (LDK) me 11 pyetje të ngritura. Në total, janë ngritur gjithsej 286 pyetje të ndryshme nga anëtarët e kuvendit të komunës së Gjilanit gjatë kësaj periudhe vlerësuese derisa pyetjet e tilla të ngritura gjatë kësaj periudhe kryesisht prinin ato të karakterit infrastrukturor (rrugë, kanalizim, trotuare, ndriçim etj.)

Lidhur me indikatorin 3.2 përkatësisht **“Numri i kontratave/projekteve të cilat anëtarët e kuvendit të komunës janë përfshirë fizikisht në mbikëqyrje të zbatimit”**, gjatë periudhës vlerësuese janë 10 anëtarë që kanë treguar angazhim. Pesë (5) nga anëtarët janë nga radhët e LVV-së dhe pesë (5) nga radhët e LDK-së. Sa i përket aspektit gjinor, 8 janë anëtarë (M) dhe 2 të tjerë janë anëtare (F).

Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, janë 3 anëtarë të kuvendit të komunës që janë vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit në këtë indikator nga fakti se kanë mbikëqyrur më shumë se dhjetë (10) projekte të ndryshme. Në mesin e anëtarëve që kanë mbikëqyrur më shumë projekte janë: Gresa Avdiu (LDK) ka mbikëqyrur 14 projekte, Gentrin Murseli (LDK) ka mbikëqyrur 12 projekte dhe Besnik Shala (LVV) ka mbikëqyrur 12 projekte.

Performanca e anëtarëve të kuvendit të komunës së Rahovecit

Kuvendi i komunës së Rahovecit numëron 31 anëtarë. Vlen të theksohet se me ekzekutivin e Rahovecit udhëheq Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) mirëpo në kuvendin e komunës nuk e gëzon shumicën përkatësisht pas kalimit të disa anëtarëve nga subjekte tjera në këtë subjekt numëron 15 anëtarë (15 AAK). Opozita në kuvendin e komunës numëron 16 anëtarë, 6 nga radhët e LDK, 5 nga PDK dhe 5 nga LVV. Nga 31 anëtarë sa numëron kuvendi i komunës së Rahovecit, pesë (5) nga ta nuk janë pjesë e vlerësimit bazuar në metodologjinë e matjes së performancës, përfshirë katër (4) shefat e grupeve parlamentare (AAK, LVV, LDK dhe PDK) si dhe kryesuesin e kuvendit të komunës. Ish kryesusi i kuvendit të komunës së Rahovecit Dëfrim Kafexhiu, është përfshirë në vlerësim të performancës që nga seanca e shkarkimit të tij⁴

Gjatë periudhës maj 2023 - shkurt 2024, janë 19 anëtarë të kuvendit të komunës së Rahovecit që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues. Në mesin e anëtarëve që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues, nga radhët e pozitës janë 7 anëtarë (7 AAK) dhe nga radhët e opozitës janë 12 anëtarë (5 LDK, 3 PDK dhe 4 nga LVV).

Në aspektin gjinor, janë 8 anëtare (F) të kuvendit të komunës së Rahovecit të cilat kanë shënuar performancë (3 AAK, 2 LVV, 2 LDK dhe 1 Pavarur) derisa janë 11 anëtarë (M) të kuvendit të komunës që kanë shënuar performancë pozitive (4 AAK, 3 LDK, 2 nga LVV, 2 nga PDK). Janë shtatë (7) anëtarë të kuvendit të komunës së Rahovecit, të cilët gjatë periudhës së vlerësimit maj 2023 – shkurt 2024 nuk kanë shënuar asnjë rezultat në asnjë nga indikatorët vlerësues dhe janë vlerësuar me zero pikë.

Në mesin e anëtarëve që nuk kanë shënuar asnjë rezultat, 4 janë nga radhët e pozitës (6 AAK) dhe një (1) nga radhët e opozitës (PDK). Në aspektin gjinor, janë 3 anëtare (F) dhe anëtarë (M) të cilët nuk kanë shënuar asnjë rezultat gjatë periudhës së vlerësimit.

Në mesin e 19 anëtarëve që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues, anëtarët e kuvendit të komunës të cilët kanë shënuar rezultate më të larta gjatë periudhës së vlerësimit janë: Ilir Pallqa (LVV) me 59 pikë, Dafina Gashi (AAK) me 37 pikë dhe Sejfullah Sejfullahu me 30 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

Anëtarët që kanë performuar më dobët gjatë kësaj periudhe janë: Fahrije Lushi Morina (LDK) me 7 pikë, Besim Berisha (AAK) me pesë (5) pikë, Rumir Zhuniqi (AAK) me pesë (5) pikë, Shqipe Kryeziu (AAK) me pesë (5) pikë, Melinda Iska (PDK) me pesë (5) pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

4 Shkarkimi është bërë më 12 korrik 2023

Anëtarët që nuk kanë performuar gjatë kësaj periudhe dhe janë vlerësuar me zero (0) pikë janë: Alban Bajraktari (AAK), Bjondina Kleqka (AAK), Dorentina Sopjani (AAK), Feriz Thaqi (AAK), Shukrije Himaj (AAK) dhe Armir Vuçitërna (PDK).

Anëtarët (F) e kuvendit të komunës së Rahovecit që kanë performuar më së miri gjatë kësaj periudhe janë: Dafina Gashi (AAK) me 37 pikë, Merisa Sharku – Vuçitërna (LVV) me 28 pikë dhe Vlora Vuçitërna – Çmega (LVV) me 20 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

Janë 19 anëtarë të kuvendit të komunës që për herë të parë kanë marrë mandatin për ti përfaqësuar qytetarët në këtë institucion. Në aspektin gjinor në këtë kategori, janë 8 anëtare (F) dhe 11 anëtarë (M), të cilët kanë fituar mandatin për herë të parë.

Katërbëdhjetë (14) anëtarë të kuvendit të komunës kanë treguar rezultate pozitive në së paku njërin nga indikatorët vlerësues (5 AAK, 4 LVV, 3 LDK, 2 PDK) mirëpo anëtarët që kanë treguar performancë më të mirë në kategorinë e përfaqësimit të qytetarëve në mandatin e parë janë: Ilir Pallqa (LVV) me 59 pikë, Dafina Gashi (AAK) me 37 pikë dhe Sejfulla Sejfullahu (PDK) me 30 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët. Në anën tjetër, janë pesë (5) anëtarë në këtë kategori të cilët nuk kanë shënuar asnjë rezultat gjatë periudhës së vlerësimit dhe janë vlerësuar me zero (0) pikë: Alban Bajraktari (AAK), Dorentina Sopjani (AAK), Feriz Thaqi (AAK), Shukrije Himaj (AAK) dhe Armir Vuçitërna (PDK).

Sa i përket klasifikimit të moshës, kuvendi i komunës së Rahovecit numëron 12 anëtarë nga mosha 18-35. Në mesin e tyre, dhjetë (10) kanë treguar performancë dhe dy (2) nuk kanë treguar performancë gjatë kësaj periudhe të vlerësimit. Anëtari Ilir Pallqa (LVV) është anëtari që ka performuar më së miri në këtë grup moshë me gjithsej 59 pikë, i ndjekur nga Dafina Gashi (AAK) me gjithsej 37 pikë, Merisa Sharku – Vuçitërna (LVV) me gjithsej 28 pikë dhe Drilon Mustafa (AAK) me 27 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët. Në aspektin gjinor në këtë grup moshë, janë 5 anëtare (F) dhe 5 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë derisa janë dy (2) anëtare (F) që nuk kanë shënuar performancë në këtë grup moshë. Anëtarët që nuk kanë shënuar asnjë rezultat në këtë grup moshë janë: Bjondina Kleqka (AAK) dhe Dorentina Sopjani (AAK).

Kuvendi i komunës së Rahovecit numëron 10 anëtarë, mosha e të cilëve është nga 36 deri 50 vjet. Pesë (5) nga anëtarët e kuvendit të komunës së Rahovecit në këtë grup moshë kanë treguar angazhim/ performancë dhe pesë (5) prej tyre nuk kanë treguar performancë dhe janë vlerësuar me zero pikë. Anëtari i kuvendit të komunës, Sejfullah Sejfullahu (PDK) është anëtari që ka performuar më së miri në këtë grup moshë me gjithsej 30 pikë, i ndjekur nga Faton Ramadani (LDK) me tetë (8) pikë dhe Farije Lushi – Morina me shtatë (7) pikë. Në aspektin gjinor në këtë grup moshë, janë 3 anëtare (F) dhe 2 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë. Anëtarët e kuvendit të komunës të cilët nuk kanë shënuar performancë në këtë grup moshë janë: Alban Bajraktari (AAK), Shukrije Himaj (AAK), Feriza Thaqi (AKK), Sinan Kryeziu (AAK) dhe Armir Vuçitërna (PDK).

Kuvendi i komunës së Rahovecit numëron 4 anëtarë, mosha e të cilëve është nga 51 e tutje. Në këtë grup moshë, 4 anëtarë treguan angazhim/performancë derisa anëtari i kuvendit të komunës Sejfulla Sejfullahu (PDK) dhe Rasim Fazliu (PDK) kanë performuar më së miri në këtë grup moshë me gjithsej 30 pikë përkatësisht 23 pike nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

Vlerësimi mbi indikatorët

Sa i përket indikatorëve vlerësues 1.1 *Numri i takimeve të organizuara nga anëtarët e kuvendit të komunës me këshillat lokal, qytetarët dhe grupet e margjinalizuara* si dhe 1.2 *“Numri i pjesëmarrësve në takimet e organizuara që i përkasin grupeve të margjinalizuara”*, gjatë periudhës vlerësuese Dafina Gashi (nga pozita përkatësisht nga AAK), është anëtarja e cila ka organizuar dy (2) takime me qytetarë, përkatësisht me grupe të cilat i përkasin grupeve të margjinalizuara dhe është anëtarja e cila është vlerësuar në këta dy indikatorë si dhe Ilir Pallqa (LVV) gjatë kësaj periudhe vlerësuese ka

organizuar një (1) takim me qytetarë, por që nuk ka pasur prezencë të anëtarëve nga grupet e marginalizuara andaj edhe është vlerësuar vetëm në indikatorin 1.1.

Lidhur me indikatorin 1.3 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave të ngritura nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës që rrjedhin nga takimet me qytetarë dhe ndërveprimet me medi-at sociale”**, gjatë kësaj periudhe vlerësuese maj 2023 – shkurt 2024, janë tetë (8) anëtarë të cilët kanë shënuar angazhim/performancë. Pesë (5) anëtarë të cilët kanë treguar rezultat në këtë indikator janë nga radhët e opozitës (4 LVV, 1 LDK) dhe tre (3) nga radhët e pozitës (3 AAK). Në aspektin gjinor, në këtë indikator kanë treguar performancë pesë (5) anëtarë (M) dhe tri (3) anëtare (F) të kuvendit.

Numrin më të madh të çështjeve/kërkesave në këtë indikator e ka ngritur Ilir Pallqa (LVV) me gjithsej 9 çështje/kërkesa dhe është i vetmi anëtar që është vlerësuar me dhjetë (10) pikë në këtë indikator. Anëtarët e tjerë që janë vlerësuar me pesë (5) pikë e të cilët kanë ngritur çështje/kërkesa që rrjedhin nga takimet me qytetarë apo ndërveprimet sociale janë: Merisa Sharku (LVV) me tri (3) çështje/kërkesa, Vlora Vuqiterna (LVV) me dy (2) çështje/kërkesa dhe Afrim Berisha (AAK), Drilon Mustafa (AAK), Florida Bajraktari (AAK), Dëfrim Kafexhiu (LVV), Lirigzon Kastrati (LDK) me nga 1 çështje/kërkesë. Në anën tjetër, janë 18 anëtarë të kuvendit të komunës së Rahovecit, të cilët janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator vlerësues.

Indikatorin 1.4 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave që kanë të bëjnë me interesin e Grupeve të Margjinalizuara të cilat janë ngritur në seancën e kuvendit”**, gjatë kësaj periudhe një anëtar ka shënuar rezultat pozitiv, Ilir Pallqa (LVV) me dy (2) pikë nga 5 pikë sa është maksimalja në këtë indikator. Në anën tjetër, janë 25 anëtarë të kuvendit të komunës së Rahovecit, të cilët janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator vlerësues.

Lidhur me indikatorin 2.1 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave të tjera me interes publik të propozuara nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës të cilat nuk janë të ndërlidhura nga takimet me qytetarë”**, gjatë periudhës vlerësuese maj 2023 - shkurt 2024, janë trembëdhjetë (13) anëtarë të kuvendit të komunës që nuk kanë ngritur ndonjë çështje dhe si rezultat janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Dhjetë (10) nga ta vijnë nga radhët e pozitës (10 AAK) dhe tre (3) nga radhët e pozitës (2 PDK, 1 LVV).

Në anën tjetër janë 13 anëtarë të kuvendit të komunës së Rahovecit të cilët kanë ngritur çështje apo kërkesa gjatë seancave të mbajtura gjatë periudhës vlerësuese. Në mesin e 13 anëtarëve që kanë treguar performancë në këtë indikator, 3 prej tyre janë nga radhët e pozitës (3 AAK) dhe 10 nga radhët e opozitës (5 LDK, 3 LVV dhe 2 PDK). Në aspektin gjinor, janë 4 anëtare (F) dhe 9 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë në këtë indikator.

Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, janë 3 anëtarë të kuvendit të komunës që janë vlerësuar me pesë (5) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit nga fakti se kanë ngritur më shumë se shtatë (7) çështje apo kërkesa gjatë periudhës vlerësuese. Pra, anëtarët që kanë ngritur numrin më të madh të çështjeve gjatë kësaj periudhe vlerësuese janë: Lirigzon Kastrati (LDK) me gjithsej 13 çështje të ngritura, Sejfullah Sejfullahu (PDK) me gjithsej 11 çështje të ngritura dhe Valmir Gashi (AAK) me gjithsej 7 çështje të ngritura. Në total, janë ngritur gjithsej 68 çështje të ndryshme nga anëtarët e kuvendit të komunës së Rahovecit gjatë kësaj periudhe vlerësuese derisa çështjet e tilla të ngritura gjatë kësaj periudhe kryesisht prinin ato të karakterit infrastrukturor (rrugë, kanalizim, ndriçim etj.).

Lidhur me indikatorin 2.2 përkatësisht **“Numri i iniciativave legislative (rregulloret komunale, propozimet për amendamentim të rregulloreve, buxheti) të propozuara nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës së kuvendit”**, gjatë periudhës maj 2023 - shkurt 2024, janë pesë (5) anëtarë të kuvendit të komunës së Rahovecit të cilët kanë treguar performancë në këtë indikator. Në mesin e tyre, një (1) vjen nga radhët e pozitës (AAK) dhe katër (4) nga radhët e opozitës (2 LVV dhe 2 AAK). Në aspektin gjinor, janë dy (2) anëtare dhe tre (3) anëtarë të kuvendit të komunës që kanë treguar performancë.

Ilir Pallqa (LVV) gjatë kësaj periudhe ka propozuar 3 iniciativa ligjore dhe me nga një (1) propozim për iniciativa ligjore kanë dhënë Dafina Gashi (AAK), Merisa Sharku (LVV), Sejfullah Sejfullahu (PDK) dhe

Rasim Fazliu (PDK). Si rezultat i propozimeve të tilla, këta anëtarë janë vlerësuar me nga pesë (5) pikë nga 10 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për këtë indikator.

Lidhur me indikatorin 2.3 përkatësisht **“Numri i propozimeve gjatë zhvillimit të dëgjimeve buxhetore për KAB dhe projekt buxhetin e komunës të organizuara nga ekzekutivi dhe legjislativi”**, gjatë monitorimit të

dëgjimeve buxhetore për KAB dhe projekt buxhetin e komunës, janë 22 anëtarë të cilët nuk kanë dhënë asnjë propozim për projekt buxhetin e komunës gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore. Katër (4) anëtarë janë vlerësuar pozitivisht në këtë indikator për shkak të dhënies së propozimeve për projekt buxhet gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore. Në mesin e 4 anëtarëve, 2 prej tyre vijnë nga radhët e opozitës (1 LVV dhe 1 PDK) dhe 2 nga radhët e pozitës (2 AAK). Përfaqësimi gjinor në këtë indikator vlerësues ishte 1 (F) me 3 (M).

Numrin më të madh të propozimeve gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore e ka dhënë Sejfullah Sejfullahu (PDK) me gjithsej 5 propozime, Dafina Gashi (AAK) dhe Drilon Mustafa (AAK) me nga 3 propozime dhe Ilir Pallqa (LVV) me 1 propozim. Katër nga këta anëtarë janë vlerësuar me nga pesë (5) pikë nga dhjetë (10) pikë sa është maksimalja e vlerësimit për këtë indikator. Vlen të ceket se 22 anëtarë të kuvendit të komunës, gjatë kësaj periudhe vlerësuese janë vlerësues me zero (0) pikë në këtë indikator, për shkak të mos angazhimit në dhënien e propozimeve gjatë zhvillimit të dëgjimeve buxhetore për KAB si dhe projekt buxhetin e komunës.

Lidhur me indikatorin 3.1 përkatësisht **“Numri i pyetjeve dhe kërkesave për raportim drejtuar anëtarëve të ekzekutivit”**, gjatë periudhës vlerësuese maj 2023 - shkurt 2024, janë 18 anëtarë të kuvendit të komunës së Rahovecit të cilët kanë treguar performancë në këtë indikator. Nga 18 anëtarë që kanë treguar performancë, 12 prej tyre janë nga radhët e opozitës (5 LDK, 3 PDK, 4 LVV) dhe 6 nga radhët e pozitës (6 AAK). Në aspektin gjinor, janë 8 anëtare (F) dhe 10 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë në këtë indikator.

Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, janë 6 anëtarë të kuvendit të komunës që janë vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit nga fakti se kanë ngritur më shumë se dhjetë (10) pyetje gjatë periudhës vlerësuese. Ndërsa anëtarët që kanë ngritur numrin më të madh të pyetjeve gjatë kësaj periudhe vlerësuese janë: Dëfrim Kafexhiu (LVV), Ilir Pallqa (LVV), Lirigzon Kastrati (LDK), Edona Kryeziu (LDK) me nga 21 pyetje të ngritura dhe Vlora Vuçitërna (LVV) dhe Rasim Fazliu (PDK) me nga 12 pyetje të ngritura. Në total, janë ngritur gjithsej 160 pyetje të ndryshme nga anëtarët e kuvendit të komunës së Rahovecit gjatë kësaj periudhe vlerësuese derisa pyetjet e tilla të ngritura gjatë kësaj periudhe kryesisht prinin ato të karakterit infrastrukturor (rrugë, kanalizim, trotuare, ndriçim etj.)

Në anën tjetër, janë 8 anëtarë të tjerë që nuk kanë treguar performancë në këtë indikator. Prej tyre 7 janë nga radhët e pozitës AAK dhe 1 nga opozita (1 PDK). Në aspektin gjinor, 3 anëtare (F) dhe 5 anëtarë (M) janë në mesin e atyre që nuk kanë treguar performancë në këtë indikator.

Lidhur me indikatorin 3.2 përkatësisht **“Numri i kontratave/projekteve të cilat anëtarët e kuvendit të komunës janë përfshirë fizikisht në mbikëqyrje të zbatimit”**, gjatë periudhës vlerësuese janë 6 anëtarë që kanë treguar angazhim. Dy (2) nga anëtarët janë nga radhët e pozitës (2 AAK) dhe kater (4) nga radhët e opozitës (3 LVV, 1 PDK). Sa i përket aspektit gjinor, 4 janë anëtarë (M) dhe 2 të tjerë janë anëtare (F).

Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, Ilir Pallqa (LVV) është anëtar i vetëm i kuvendit të komunës që është vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit në këtë indikator nga fakti se ka mbikëqyrur më shumë se gjashtë (6) projekte të ndryshme. Në mesin e anëtarëve që kanë mbikëqyrur më shumë projekte janë: Ilir Pallqa (LVV) ka mbikëqyrur 9 projekte, Dafina Gashi (AAK) ka mbikëqyrur 5 projekte, Drilon Mustafa (AAK) ka mbikëqyrur 2 projekte dhe Merisa Sharku (LVV), Dëfrim Kafexhiu (LVV) si dhe Fejzullah Fejzullahu (PDK) kanë mbikëqyrur nga 1 projekt.

Në anën tjetër, janë 20 anëtarë të tjerë që nuk kanë treguar performancë në këtë indikator. Prej tyre 10 janë nga radhët e pozitës (AAK) dhe 10 nga opozita (2 LVV, 5 LDK dhe 3 PDK). Në aspektin gjinor, 9 anëtare (F) dhe 11 anëtarë (M) janë në mesin e atyre që nuk kanë treguar performancë në këtë indikator.

Performanca e anëtarëve të kuvendit të komunës së Malishevës

Kuvendi i komunës së Malishevës numëron 31 anëtarë. Pozita në kuvendin e komunës numëron 16 anëtarë, 10 nga radhët e NISMA dhe 6 nga radhët e LDK derisa opozita numëron 15 anëtarë (8 nga PDK, 5 nga LVV dhe 2 nga AAK). Nga 31 anëtarë sa numëron kuvendi i komunës së Malishevës, gjashtë (6) nga ta nuk janë pjesë e vlerësimit bazuar në metodologjinë e matjes së performancës, përfshirë pesë (5) shefat e grupeve parlamentare (NISMA, LDK, PDK, LVV dhe AAK) si dhe kryesuesin e kuvendit të komunës.

Gjatë periudhës maj 2023 - shkurt 2024, janë 16 anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues. Në mesin e anëtarëve që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues, nga radhët e pozitës janë 7 anëtarë (5 NISMA dhe 2 LDK) dhe nga radhët e opozitës janë 9 anëtarë (5 PDK dhe 4 nga LVV).

Në aspektin gjinor, janë 6 anëtare (F) të kuvendit të komunës së Malishevës të cilat kanë shënuar performancë (2 NISMA, 2 PDK dhe 2 LVV) derisa janë 10 anëtarë (M) të kuvendit të komunës që kanë shënuar performancë pozitive (3 NISMA, 3 PDK, 2 LDK dhe 2 LVV).

Janë nëntë (9) anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës, të cilët gjatë periudhës së vlerësimit maj 2023 – shkurt 2024 nuk kanë shënuar asnjë rezultat në asnjë nga indikatorët vlerësues dhe janë vlerësuar me zero pikë. Në mesin e anëtarëve që nuk kanë shënuar asnjë rezultat, 6 janë nga radhët e pozitës (4 NISMA dhe 2 LDK) dhe tre (3) nga radhët e opozitës (2 PDK dhe 1 AAK). Në aspektin gjinor, janë 5 anëtare (F) dhe 4 anëtarë (M) të cilët nuk kanë shënuar asnjë rezultat gjatë periudhës së vlerësimit.

Në mesin e 16 anëtarëve që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues, anëtarët e kuvendit të komunës të cilët kanë shënuar rezultate më të larta gjatë periudhës së vlerësimit janë: Amrush Helshani (NISMA) me 52 pikë, Burim Paçarizi (PDK) dhe Alban Kastrati (PDK) me nga 20 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

Anëtarët që kanë performuar më dobët gjatë kësaj periudhe janë: Bledar Kryeziu (PDK), Rukije Bytyqi (NISMA), Arlind Morina (LVV) dhe Arbnore Hoti (LVV) me nga 2 pikë.

Anëtarët që nuk kanë performuar gjatë kësaj periudhe dhe janë vlerësuar me zero (0) pikë janë: Bashkim Berisha (NISMA), Hasim Rudi (NISMA), Urim Thaqi (NISMA), Fjoralba Hoxha (NISMA), Sadik Vrenezi (PDK), Arlinda Rudi (PDK), Zamire Morina (LDK), Adile Hoxha (LDK) dhe Donjeta Shijaku (AAK).

Anëtarët (F) e kuvendit të komunës së Malishevës që kanë performuar më së miri gjatë kësaj periudhe janë: Agnesa Kastrati (LVV) me 15 pikë, Gentiana Morina (NISMA), Merlinda Gashi (PDK) dhe Valjete Hoti (PDK) me nga 7 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

Nga aspekti i përfaqësimit të subjekteve politike, nëntë (9) anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës të përfaqësuar nga subjektet e ndryshme politike janë vlerësuar negativisht dhe ndër ta janë katër (4) anëtarë nga NISMA, 2 nga PDK, 2 nga LDK dhe 1 nga AAK.

Janë 18 anëtarë të kuvendit të komunës që për herë të parë kanë marrë mandatin për ti përfaqësuar qytetarët në këtë institucion. Ne aspektin gjinor në këtë kategori, janë 9 anëtare (F) dhe 9 anëtarë (M), të cilët kanë fituar mandatin për herë të parë. Në mesin e anëtarëve që kanë fituar mandatin për herë të parë, tetë (8) prej tyre nuk kanë treguar asnjë rezultat gjatë periudhës së vlerësimit dhe janë poentuar me zero (0) pikë. Gjashtë nga ta (6) vijnë nga radhët e pozitës (4 NISMA dhe 2 LDK) si dhe dy nga radhët e opozitës (2 PDK). Në aspektin gjinor, janë katër (4) anëtare (F) dhe katër (4) anëtarë (M) të cilët nuk kanë treguar performancë në asnjë nga indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Në anën tjetër, janë dhjetë (10) anëtarë në këtë kategori ku edhe kanë treguar rezultate në indikatorët vlerësues. Në mesin e anëtarëve që kanë treguar rezultate gjatë periudhës së vlerësimit, pesë (5) vijnë nga radhët e pozitës (4 NISMA dhe 1 LDK) dhe pesë (5) nga radhët e opozitës (3 PDK dhe 2 LVV). Në aspektin gjinor, në këtë kategori janë pesë (5) anëtare (F) dhe pesë (5) anëtarë (M) të cilët kanë treguar performancë në indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe. Në mesin e këtyre anëtarëve që kanë performuar më mirë në këtë kategori janë: Amrush Helshani (NISMA), Valon Mazreku (NISMA), Burim Paçarizi (PDK) dhe Agnesa Kastrati (LVV).

Sa i përket klasifikimit të moshës, kuvendi i komunës së Malishevës numëron 14 anëtarë nga mosha 18-35. Në mesin e tyre, gjashtë (6) anëtarët nuk kanë treguar performancë, në mesin e tyre katër (4) nga pozita (2 NISMA dhe 2 LDK) si dhe dy (2) nga opozita (1 PDK dhe 1 AAK). Në aspektin gjinor, në këtë kategori nuk kanë performuar pesë (5) anëtare (F) dhe një (1) anëtar (M) i kuvendit të komunës.

Në anën tjetër, në këtë grup moshë janë tetë (8) anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës të cilët kanë treguar performancë. Në mesin e tyre, tre (3) vijnë nga radhët e pozitës (3 NISMA) dhe pesë (5) nga radhët e opozitës (3 PDK dhe 2 LVV). Në aspektin gjinor, në këtë kategori kanë performuar tri (3) anëtare (F) dhe pesë (5) anëtarë të kuvendit të komunës. Në mesin e këtyre anëtarëve që kanë performuar më mirë në këtë grup moshë janë: Amrush Helshani (NISMA), Burim Paçarizi (PDK) dhe Agnesa Kastrati (LVV).

Kuvendi i komunës së Malishevës numëron 11 anëtarë, moshë e të cilëve është nga 36 deri 50 vjet. Në mesin e tyre, tre (3) anëtarët nuk kanë treguar performancë, në mesin e tyre dy (2) nga pozita (2 NISMA) si dhe një (1) nga opozita (1 PDK). Në aspektin gjinor, në këtë kategori nuk kanë performuar tre (3 F) anëtare të kuvendit të komunës.

Në anën tjetër, në këtë grup moshë janë tetë (8) anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës të cilët kanë treguar performancë. Në mesin e tyre, katër (4) vijnë nga radhët e pozitës (2 NISMA dhe 2 LDK) dhe katër (4) nga radhët e opozitës (2 LVV dhe 2 PDK). Në aspektin gjinor, në këtë kategori kanë performuar tri (3) anëtare (F) dhe pesë (5) anëtarë të kuvendit të komunës. Në mesin e këtyre anëtarëve që kanë performuar më mirë në këtë grup moshë: Alban Kastrati (PDK), Valon Krasniqi (LVV) dhe Valon Mazreku (NISMA).

Kuvendi i komunës së Malishevës, nuk ka asnjë anëtar për vlerësim moshë e të cilëve është nga 51 e tutje.

Vlerësimi mbi indikatorët

Sa i përket indikatorëve vlerësues 1.1 “*Numri i takimeve të organizuara nga anëtarët e kuvendit të komunës me këshillat lokal, qytetarët dhe grupet e marginalizuara*” dhe 1.2 “*Numri i pjesëmarrësve në takimet e organizuara që i përkasin grupeve të marginalizuara*”, gjatë periudhës vlerësuese Amrush Helshani (nga pozita përkatësisht nga NISMA), është anëtari i cili ka organizuar tetë (8) takime me qytetarë, përkatësisht me grupe të cilat i përkasin grupeve të marginalizuara dhe është anëtari i cili është vlerësuar në këta dy indikatorë (indikator 1.1 dhe 1.2). Në anën tjetër, 24 anëtarë

të kuvendit të komunës së Malishevës, gjatë periudhës vlerësuese nuk kanë organizuar asnjë takim me qytetarë apo grupe të marginalizuara, duke u vlerësuar me zero (0) pikë në dy nga indikatorët, përkatësisht indikatorin 1.1 dhe 1.2.

Lidhur me indikatorin 1.3 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave të ngritura nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës që rrjedhin nga takimet me qytetarë dhe ndërveprimet me mediat sociale”**, gjatë kësaj periudhe vlerësuese maj 2023 – shkurt 2024, janë katër (4) anëtarë të cilët kanë shënuar angazhim/performancë. Katër (4) anëtarët të cilët kanë treguar rezultat në këtë indikator janë nga radhët e opozitës (2 PDK dhe 1 LVV) dhe një (1) nga radhët e pozitës (1 NISMA). Në aspektin gjinor, në këtë indikator kanë treguar performancë katër (4) anëtarë (M) të kuvendit.

Numrin më të madh të çështjeve/kërkesave në këtë indikator e ka ngritur Amrush Helshani (NISMA) me gjithsej 7 çështje/kërkesa dhe është i vetmi anëtar që është vlerësuar me dhjetë (10) pikë në këtë indikator. Anëtarët e tjerë që janë vlerësuar me pesë (5) pikë e të cilët kanë ngritur çështje/kërkesa që rrjedhin nga takimet me qytetarë apo ndërveprimet sociale janë: Valon Krasniqi (LVV) me 5 çështje/kërkesa të ngritura si dhe Burim Paçarizi (PDK) dhe Bledar Kryeziu (PDK) me nga një (1) çështje/kërkesë. Në anën tjetër, janë 21 anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës, të cilët janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator vlerësues.

Lidhur me indikatorin 1.4 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave që kanë të bëjnë me interesin e Grupeve të Margjinalizuara të cilat janë ngritur në seancën e kuvendit”**, gjatë kësaj periudhe një anëtar ka shënuar rezultat pozitiv, Amrush Helshani (NISMA) nga radhët e pozitës. Në anën tjetër, janë 24 anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës, të cilët janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator vlerësues.

Lidhur me indikatorin 2.1 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave të tjera me interes publik të propozuara nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës të cilat nuk janë të ndërlidhura nga takimet me qytetarë”**, gjatë periudhës vlerësuese maj 2023 deri shkurt 2024, janë njëmbëdhjetë (11) anëtarë të kuvendit të komunës që nuk kanë ngritur ndonjë çështje dhe si rezultat janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Shtatë (7) nga ta vijnë nga radhët e pozitës (4 NISMA, 3 LDK) dhe katër (4) nga radhët e opozitës (3 PDK, 1 AAK). Në aspektin gjinor, janë 5 anëtare (F) dhe 6 anëtarë (M) që nuk kanë shënuar performancë në këtë indikator.

Në anën tjetër janë 14 anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës të cilët kanë ngritur çështje apo kërkesa gjatë seancave të mbajtura gjatë periudhës vlerësuese. Në mesin e 14 anëtarëve që kanë treguar

performancë në këtë indikator, 6 prej tyre janë nga radhët e pozitës (5 NISMA dhe 1 LDK) dhe 8 nga radhët e opozitës (4 LVV dhe 4 PDK). Në aspektin gjinor, janë 6 anëtare (F) dhe 8 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë në këtë indikator. Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, janë 5 anëtarë të kuvendit të komunës që janë vlerësuar me pesë (5) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit nga fakti se kanë ngritur më shumë se shtatë (7) çështje apo kërkesa gjatë periudhës vlerësuese.

Ndërsa anëtarët që kanë ngritur numrin më të madh të çështjeve gjatë kësaj periudhe vlerësuese janë: Vlon Mazreku (NISMA) me gjithsej 18 çështje të ngritura, Alban Kastrati (PDK) me gjithsej 14 çështje të ngritura, Valon Krasniqi (LVV) me gjithsej 13 çështje të ngritura, Burim Paçarizi (PDK) me 11 çështje të ngritura dhe Agnesa Kastrati (LVV) me 9 çështje të ngritura. Në total, janë ngritur gjithsej 85 çështje të ndryshme nga anëtarët e kuvendit të komunës së Malishevës gjatë kësaj periudhe vlerësuese derisa çështjet e tilla të ngritura gjatë kësaj periudhe kryesisht prinin ato të karakterit infrastrukturor (rrugë, kanalizim, ndriçim etj.)

Lidhur me indikatorin 2.2 përkatësisht **“Numri i iniciativave legjislative (rregulloret komunale, propozimet për amandamentim të rregulloreve, buxheti) të propozuara nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës së kuvendit”**, gjatë periudhës maj 2023 dhe shkurt 2024, janë katër (4) anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës të cilët kanë treguar performancë në këtë indikator. Në mesin e tyre, tre (3) vijnë nga radhët e pozitës (2 NISMA dhe 1 LDK) dhe një (1) nga radhët e opozitës

(1 LVV). Në aspektin gjinor, janë një (1) anëtare dhe tre (3) anëtarë të kuvendit të komunës që kanë treguar performancë.

Driton Kastrati (LDK) dhe Valon Krasniqi (LVV) gjatë kësaj periudhe kanë propozuar nga 2 iniciativa ligjore dhe me nga një (1) propozim për iniciativa ligjore kanë dhënë Valon Mazreku (NISMA) dhe Gentiana Hoti (NISMA). Si rezultat i propozimeve të tilla, këta anëtarë janë vlerësuar me nga pesë (5) pikë nga 15 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për këtë indikator.

Lidhur me indikatorin 2.3 përkatësisht **“Numri propozimeve gjatë zhvillimit të dëgjimeve buxhetore për KAB dhe projekt buxhetin e komunës të organizuara nga ekzekutivi dhe legjislativi”**, gjatë monitorimit të dëgjimeve buxhetore për KAB dhe projekt buxhetin e komunës, asnjë nga anëtarët e kuvendit të komunës së Malishevës nuk kanë dhënë propozim për projekt buxhetin e komunës gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore.

Lidhur me indikatorin 3.1 përkatësisht **“Numri i pyetjeve dhe kërkesave për raportim drejtuar anëtarëve të ekzekutivit”**, gjatë periudhës vlerësuese maj 2023 dhe shkurt 2024, janë 9 anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës të cilët kanë treguar performancë në këtë indikator. Nga 9 anëtarë që kanë treguar performancë, 4 prej tyre janë nga radhët e pozitës (2 NISMA dhe 2 LDK) dhe 5 nga radhët e opozitës (4 PDK dhe 1 LVV). Në aspektin gjinor, janë 3 anëtare (F) dhe 6 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë në këtë indikator. Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, Alban Kastrati është anëtari i kuvendit të komunës që është vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit nga fakti se kanë ngritur më shumë se dhjetë (10) pyetje gjatë periudhës vlerësuese. Pra, anëtarët që kanë ngritur numrin më të madh të pyetjeve gjatë kësaj periudhë vlerësuese janë: Alban Kastrati (LVV) me 15 pyetje të ngritura, Amrush Helshani (NISMA), Burim Paçarizi (PDK) dhe Agnesa Kastrati (LVV) me nga 10 pyetje të ngritura. Në total, janë ngritur gjithsej 52 pyetje të ndryshme nga anëtarët e kuvendit të komunës së Malishevës gjatë kësaj periudhe vlerësuese derisa pyetjet e tilla të ngritura gjatë kësaj periudhe kryesisht prinin ato të karakterit infrastrukturor (rrugë, kanalizim, trotuare, ndriçim etj.)

Lidhur me indikatorin 3.2 përkatësisht **“Numri i kontratave/projekteve të cilat anëtarët e kuvendit të komunës janë përfshirë fizikisht në mbikëqyrje të zbatimit”**, gjatë periudhës vlerësuese janë 2 anëtarë që kanë treguar angazhim dhe të dy (2) anëtarët janë nga radhët e pozitës (2 NISMA).

Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, Amrush Helshani (NISMA) është anëtari i kuvendit të komunës që është vlerësuar me dhjetë (10) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit në këtë indikator nga fakti se ka mbikëqyrur gjashtë (6) projekte të ndryshme si dhe Astrit Sertolli (NISMA) është vlerësuar me pesë (5) pikë nga fakti se ka mbikëqyrur 3 projekte të ndryshme. Në anën tjetër, 23 anëtarët e kuvendit të komunës së Malishevës që kanë qenë pjesë e vlerësimit të performancës, gjatë kësaj periudhë nuk kanë pasur ndonjë iniciativë për të mbikëqyrur zbatimin e projekteve të ndryshme nga ana e ekzekutivit komunal.

Performanca e anëtarëve të kuvendit të komunës së Istogut

Kuvendi i komunës së Istogut numëron 27 anëtarë. Nga 27 anëtarë sa numëron kuvendi i komunës së Istogut, pesë (5) nga ta nuk janë pjesë e vlerësimit bazuar në metodologjinë e matjes së performancës, përfshirë katër (4) shefat e grupeve parlamentare (LDK, PDK, AAK dhe LVV) si dhe kryesuesin e kuvendit të komunës.

Gjatë periudhës maj 2023 - shkurt 2024, janë 21 anëtarë të kuvendit të komunës së Istogut që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues. Në mesin e anëtarëve që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues, nga radhët e pozitës janë dhjetë (10) anëtarë (8 LDK dhe 2 PDK) dhe nga radhët e opozitës janë 11 anëtarë (6 AAK, 4 LVV dhe 1 GIBPDK). Në aspektin gjinor, janë 9 anëtare (F) të kuvendit të komunës së Istogut të cilat kanë shënuar performancë (3 LDK, 3 AAK, 2 LVV dhe 1 PDK) derisa janë 12 anëtarë (M) të kuvendit të komunës që kanë shënuar performancë pozitive (5 LDK, 3 AAK, 2 LVV, 1 PDK dhe 1 GIBI). Gjatë kësaj periudhe të vlerësimit, një (1) anëtare e kuvendit të komunës nuk ka shënuar asnjë rezultat në indikatorët vlerësues dhe është vlerësuar me zero (0) pikë.

Në mesin e 21 anëtarëve që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues, anëtarët e kuvendit të komunës të cilët kanë shënuar rezultate më të larta gjatë periudhës së vlerësimit janë: Niman Beqiraj (LVV) me 40 pikë, Nexhdet Ramaj (AAK) me 32 pikë dhe Arta Balaj (LDK) me 26 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

Anëtarët që kanë performuar më dobët gjatë kësaj periudhe janë: Visar Haxhijaj (PDK) me dy (2) pikë, dhe me nga pesë (5) pikë janë vlerësuar Faik Alushaj (LDK), Faruk Kabashi (LDK), Ruzhdi Metaj (LDK), Arianit Amiraj (AAK), Ardita Idrizaj (AAK), Nexhmedin Balaj (AAK), dhe Melis Smakiç (GIBI). Në anën tjetër anëtarja që nuk ka performuar gjatë kësaj periudhe dhe është vlerësuar me zero (0) pikë është Njomza Demaj (LDK).

Anëtarët (F) e kuvendit të komunës së Istogut që kanë performuar më së miri gjatë kësaj periudhe janë: Arta Balaj (LDK) me 26 pikë, Ajshe Metaj (AAK) me 23 pikë dhe Floriana Maxharaj me 22 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

Janë 13 anëtarë të kuvendit të komunës që për herë të parë kanë marrë mandatin për ti përfaqësuar qytetarët në këtë institucion. Në aspektin gjinor në këtë kategori, janë 5 anëtare (F) dhe 8 anëtarë (M), të cilët kanë fituar mandatin për herë të parë. Në mesin e anëtarëve që kanë fituar mandatin për herë të parë, trembëdhjetë (13) prej tyre kanë treguar rezultat gjatë periudhës së vlerësimit, ku pesë (5) vijnë nga radhët e pozitës (4 LDK dhe 1 PDK) dhe tetë (8) nga radhët e opozitës (4 AAK, 3 LVV dhe 1 GIBI). Në mesin e këtyre anëtarëve që kanë performuar më mirë në këtë kategori janë: Niman Beqiraj (LVV) me 40 pikë, Nexhdet Ramaj (AAK) me 32 pikë dhe Arta Balaj (LDK) me 26 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

Sa i përket klasifikimit të moshës, kuvendi i komunës së Istogut numëron 9 anëtarë nga moshe 18-35. Në mesin e tyre, një (1) anëtare nuk ka treguar performancë (1 LDK). Në anën tjetër, në këtë grup moshë janë tetë (8) anëtarë të kuvendit të komunës së Istogut të cilët kanë treguar performancë. Në mesin e tyre, katër (4) vijnë nga radhët e pozitës (3 LDK dhe 1 PDK) dhe katër (4) nga radhët e opozitës (2 LVV, 1 AAK dhe 1 GIBI). Në aspektin gjinor, në këtë kategori nuk kanë performuar pesë (5) anëtare (F) dhe tre (3) anëtarë (M) të kuvendit të komunës. Në mesin e këtyre anëtarëve që kanë performuar më mirë në këtë grup moshë janë: Niman Beqiraj (LVV), Arta Balaj (LDK) dhe Floriana Maxharraj (LVV).

Kuvendi i komunës së Istogut numëron 9 anëtarë, moshë e të cilëve është nga 36 deri 50 vjet. Në këtë grup moshë janë nëntë (9) anëtarë të kuvendit të komunës së Istogut të cilët kanë treguar performancë. Në mesin e tyre, katër (4) vijnë nga radhët e pozitës (3 LDK dhe 1 PDK) dhe pesë (5) nga radhët e opozitës (4 AAK dhe 1 LVV). Në aspektin gjinor, në këtë kategori kanë performuar një (1) anëtare (F) dhe tetë (8) anëtarë (M) të kuvendit të komunës. Në mesin e këtyre anëtarëve që kanë performuar më mirë në këtë grup moshë janë: Negjdet Ramaj (AAK) dhe Arian Shatri (LVV).

Kuvendi i komunës së Istogut numëron 4 anëtarë, moshë e të cilëve është nga 51 e tutje. Në këtë grup moshë janë katër (4) anëtarë të kuvendit të komunës së Istogut të cilët kanë treguar performancë. Në mesin e tyre, dy (2) vijnë nga radhët e pozitës (2 LDK) dhe dy (2) nga radhët e opozitës (1 AAK dhe 1 LVV). Në aspektin gjinor, në këtë kategori kanë performuar tri (3) anëtare (F) dhe një (1) anëtar i kuvendit të komunës. Në mesin e këtyre anëtarëve që kanë performuar më mirë në këtë grup moshë janë: Ajshe Metaj (AAK) dhe Valbone Demaj (LDK).

Vlerësimi mbi indikatorët

Sa i përket indikatorëve vlerësues 1.1, **“Numri i takimeve të organizuara nga anëtarët e kuvendit të komunës me këshillat lokal, qytetarët dhe grupet e marginalizuara”** dhe 1.2 **“Numri i pjesëmarrësve në takimet e organizuara që i përkasin grupeve të marginalizuara”**, gjatë periudhës vlerësuese Arta Balaj (nga pozita përkatësisht nga LDK), është anëtarja e cila ka organizuar një (1) takim me qytetarë, ku pjesëmarrës ishin edhe qytetarë të cilët i përkasin grupeve të marginalizuara dhe është anëtarja e vetme e cila është vlerësuar në këta dy indikatorë (indikatorin 1.1 dhe 1.2). Në anën tjetër, 21 anëtarë të kuvendit të komunës së Istogut, gjatë periudhës vlerësuese nuk kanë organizuar asnjë takim me qytetarë apo grupe të marginalizuara, duke u vlerësuar me zero (0) pikë në dy nga indikatorët, përkatësisht indikatorin 1.1 dhe 1.2.

Lidhur me indikatorin 1.3 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave të ngritura nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës që rrjedhin nga takimet me qytetarë dhe ndërveprimet me mediën sociale”**, gjatë kësaj periudhe vlerësuese maj 2023 – shkurt 2024, janë dy (2) anëtarë të cilët kanë shënuar angazhim/performancë. Një (1) anëtar i cili ka treguar rezultat në këtë indikator vjen nga radhët e opozitës (1 LVV) dhe një (1) nga radhët e pozitës (1 PDK). Në aspektin gjinor, në këtë indikator kanë treguar performancë një (1) anëtare (F) dhe një (1) anëtar (M) i kuvendit.

Anëtarët e tjerë që janë vlerësuar me pesë (5) pikë e të cilët kanë ngritur çështje/kërkesa që rrjedhin nga takimet me qytetarë apo ndërveprimet sociale janë: Arian Shatri (LVV) me 1 çështje/kërkesë të ngritur si dhe Era Visoqi (PDK) me një (1) çështje/kërkesë të ngritur. Në anën tjetër, janë 20 anëtarë të kuvendit të komunës së Istogut, të cilët janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator vlerësues.

Indikatorin 1.4 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave që kanë të bëjnë me interesin e grupeve të marginalizuara të cilat janë ngritur në seancën e kuvendit”**, gjatë kësaj periudhe janë dy anëtarë që kanë shënuar rezultat pozitiv, Era Visoqi (LVV) dhe Arian Shatri (LVV) me nga pesë (5) pikë. Në anën tjetër, janë 20 anëtarë të kuvendit të komunës së Istogut, të cilët janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator vlerësues.

Lidhur me indikatorin 2.1 përkatësisht **“Numri i çështjeve/kërkesave të tjera me interes publik të propozuara nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës të cilat nuk janë të ndërlidhura**

nga takimet me qytetarë”, gjatë periudhës vlerësuese maj 2023 deri shkurt 2024, janë dhjetë (10) anëtarë të kuvendit të komunës që nuk kanë ngritur ndonjë çështje dhe si rezultat janë vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Gjashtë (6) nga ta vijnë nga radhët e pozitës (5 LDK dhe 1 PDK) dhe katër (4) nga radhët e opozitës (2 AAK, 1 LVV dhe 1 GIBI). Në aspektin gjinor, dhe 7 anëtarë (M) dhe tre (3) anëtare (F) që nuk kanë shënuar performancë në këtë indikator.

Në anën tjetër janë 12 anëtarë të kuvendit të komunës së Istogut të cilët kanë ngritur çështje apo kërkesa gjatë seancave të mbajtura gjatë periudhës vlerësuese. Në mesin e 12 anëtarëve që kanë treguar performancë në këtë indikator, 6 prej tyre janë nga radhët e pozitës (5 LDK dh 1 PDK) dhe 6 nga radhët e opozitës (3 LVV dhe 3 AAK). Në aspektin gjinor, janë 7 anëtare (F) dhe 5 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë në këtë indikator. Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, është një (1) anëtar i kuvendit të komunës që është vlerësuar me pesë (5) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit nga fakti se ka ngritur më shumë se shtatë (7) çështje apo kërkesa gjatë periudhës vlerësuese.

Pra, anëtarët që kanë ngritur numrin më të madh të çështjeve gjatë kësaj periudhë vlerësuese janë: Niman Beqiraj (LVV) me gjithsej 17 çështje të ngritura, Valbone Demaj (LDK) dhe Ajshe Metaj (AAK) me nga 5 çështje të ngritura. Në total, janë ngritur gjithsej 40 çështje të ndryshme nga anëtarët e kuvendit të komunës së Istogut gjatë kësaj periudhe vlerësuese derisa çështjet e tilla të ngritura gjatë kësaj periudhe kryesisht prinin ato të karakterit infrastrukturor (rrugë, kanalizim, ndriçim etj.)

Lidhur me indikatorin 2.2 përkatësisht **“Numri i iniciativave legjislative (rregulloret komunale, propozimet për amandamentim te rregulloreve, buxheti) të propozuara nga anëtarët e kuvendit të komunës gjatë seancës së kuvendit”**, gjatë periudhës maj 2023 shkurt 2024, janë katër (4) anëtarë të kuvendit të komunës së Istogut të cilët kanë treguar performancë në këtë indikator.

Në mesin e tyre, dy (2) vijnë nga radhët e pozitës (2 LDK) dhe dy (2) nga radhët e opozitës (2 AAK). Në aspektin gjinor, janë tri (3) anëtare (F) dhe një (1) anëtar i kuvendit të komunës që kanë treguar performancë. Ajshe Metaj (AAK) gjatë kësaj periudhe ka propozuar 2 iniciativa ligjore dhe me nga një (1) propozim për iniciativa ligjore kanë dhënë Arta Balaj (LDK), Hajrush Shoshi (LDK) dhe Fjolla Ukaj (AAK). Si rezultat i propozimeve te tilla, këta anëtarë janë vlerësuar me nga pesë (5) pikë nga 10 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për këtë indikator.

Lidhur me indikatorin 2.3 përkatësisht **“Numri propozimeve gjatë zhvillimit të dëgjimeve buxhetore për KAB dhe projekt buxhetin e komunës të organizuara nga ekzekutivi dhe legjislativi”**, gjatë monitorimit të dëgjimeve buxhetore për KAB dhe projekt buxhetin e komunës, janë 21 anëtarë të cilët nuk kanë dhënë asnjë propozim për projekt buxhetin e komunës gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore. Anëtarja që është vlerësuar pozitivisht vjen nga radhët e pozitës (LDK) Valbone Demaj, e cila ka dhënë 5 propozime për projekt buxhet gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore dhe është vlerësuar me pesë (5) pikë nga 15 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për këtë indikator.

Lidhur me indikatorin 3.1 përkatësisht **“Numri i pyetjeve dhe kërkesave për raportim drejtuar anëtarëve të ekzekutivit”**, gjatë periudhës vlerësuese maj 2023 dhe shkurt 2024, janë 16 anëtarë të kuvendit të komunës së Istogut të cilët kanë treguar performancë në këtë indikator. Nga 16 anëtarë që kanë treguar performancë, 7 prej tyre janë nga radhët e pozitës (7 LDK) dhe 9 nga radhët e opozitës (6 AAK dhe 3 LVV). Në aspektin gjinor, janë 8 anëtare (F) dhe 8 anëtarë (M) që kanë shënuar performancë në këtë indikator.

Në kuadër të vlerësimit të këtij indikator, Ajshe Metaj (AAK), Negjdet Ramaj (AAK), Floriana Maxharraj (LVV) dhe Niman Beqiraj (LVV) janë anëtarët e kuvendit të komunës që janë vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit nga fakti se kanë ngritur më shumë se dhjetë (10) pyetje gjatë periudhës vlerësuese. Pra anëtarët që kanë ngritur numrin më të madh të pyetjeve gjatë kësaj periudhë vlerësuese janë: Ajshe Metaj (AAK) dhe Niman Beqiraj (LVV) me nga 18 pyetje të ngritura, Negjdet Ramaj (AAK) me 13 pyetje të ngritura dhe Floriana Maxharraj (LVV) me 9 pyetje të ngritura. Në total, janë ngritur gjithsej 85 pyetje të ndryshme nga anëtarët e kuvendit të komunës së Istogut gjatë kësaj periudhe vlerësuese derisa pyetjet e tilla të ngritura gjatë kësaj periudhe kryesisht prinin ato të karakterit infrastrukturor (rrugë, kanalizim, trotuare, ndriçim etj.)

Lidhur me indikatorin 3.2 përkatësisht **“Numri i kontratave/projekteve të cilat anëtarët e kuvendit të komunës janë përfshirë fizikisht në mbikëqyrje të zbatimit”**, gjatë periudhës vlerësuese janë 6 anëtarë që kanë treguar angazhim dhe tre (3) nga anëtarët janë nga radhët e pozitës (3 LDK) dhe tre (3) nga radhët e opozirës (1 AAK, 1 LVV dhe 1 GIBI).

Në kuadër të vlerësimit të këtij indikatori, Niman Beqiraj (LVV) është anëtari i kuvendit të komunës që është vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit në këtë indikator nga fakti se ka mbikëqyrur dhjetë (10) projekte të ndryshme si dhe Negjdet Ramaj (AAK) është vlerësuar me dhjetë (10) pikë nga fakti se ka mbikëqyrur 4 projekte të ndryshme. Me nga pesë (5) pikë në këtë indikator janë vlerësuar Arta Balaj (LDK), Ruzhdi Metaj (LDK), Valbone Demaj (LDK) si dhe Melis Smakic (GIBI). Në anën tjetër, 16 anëtarë të kuvendit të komunës së Istogut që kanë qenë pjesë e vlerësimit të performancës, gjatë kësaj periudhë nuk kanë pasur ndonjë iniciative për të mbikëqyrur zbatimin e projekteve të ndryshme nga ana e ekzekutivit komunal.

Performanca e anëtarëve të kuvendit të komunës së Kllokotit

Kuvendi i komunës së Kllokotit numron 15 anëtarë. Nga 15 anëtarë sa numëron kuvendi i komunës së Kllokotit, kryesuesi i kuvendit të komunës nuk është pjesë e matjes andaj vetëm për 14 anëtarë të tjerë është bërë matja e performancës gjatë muajve maj 2023 – shkurt 2024. Opozita në kuvendin e komunës së Kllokotit numron 9 anëtarë (3 SN.Sloga, 2 N.Jedinstvo, 2 IQK Mogilla, 1 LVV dhe 1 PDK) derisa pozita numron 6 anëtarë (5 Lista Serbe dhe 1 LDK).

Gjatë periudhës maj 2023 - shkurt 2024, janë 10 anëtarë të kuvendit të komunës së Kllokotit që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues. Në mesin e anëtarëve që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues, nga radhët e pozitës janë 5 anëtarë (4 L.Serbe dhe 1 LDK) dhe nga radhët e opozitës janë 5 anëtarë (1 S.N Sloga, 1 Jedinstvo, 1 IQK Mogilla, 1 LVV dhe 1 PDK). Në aspektin gjinor, janë 3 anëtare (F) të kuvendit të komunës së Kllokotit të cilat kanë shënuar performancë (2 L.Serbe dhe 1 LDK) derisa janë 7 anëtarë (M) të kuvendit të komunës që kanë shënuar performancë pozitive (2 L.Serbe, 1 S.N Sloga, 1 Jedinstvo, 1 IQK Mogilla, 1 LVV dhe 1 PDK).

Gjatë kësaj periudhe të vlerësimit, katër (4) anëtarë të kuvendit të komunës nuk kanë shënuar asnjë rezultat në indikatorët vlerësues dhe janë vlerësuar me zero (0) pikë. Në mesin e anëtarëve që nuk kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues nga radhët e opozitës janë 4 anëtarë (2 S.N Sloga, 1 Jedinstvo, 1 IQK Mogilla). Në aspektin gjinor, janë 3 anëtare (F) të kuvendit të komunës së Kllokotit të cilat nuk kanë shënuar performancë (1 S.N Sloga, 1 Jedinstvo, 1 IQK Mogilla) derisa është 1 anëtar (M) i kuvendit të komunës që nuk ka shënuar performancë pozitive (1 S.N Sloga).

Në mesin e 10 anëtarëve që kanë shënuar rezultate pozitive në indikatorët vlerësues, anëtarët e kuvendit të komunës të cilët kanë shënuar rezultate më të larta gjatë periudhës së vlerësimit janë: Admirim Etemi (LVV) me 28 pikë si dhe Shqiprim Rexhepi (IQK Mogilla) dhe Naser Shabani me nga 20 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

Anëtarët që kanë performuar më dobët gjatë kësaj periudhe janë: Mirjana Spasic (L.Serbe) dhe Dejan Nojkic (L.Serbe) me nga pesë (5) pikë si dhe Igor Petkovic (L.Serbe) me 2 pikë.

Në anën tjetër anëtarët që nuk kanë performuar gjatë kësaj periudhe dhe janë vlerësuar me zero (0) pikë janë: Milorad Mirkovic (S.N Sloga), Kristina Vesic (S.N Sloga), Sladjana Cvetkovic (N.Jedinstvo) dhe Nermina Fejza (IQK Mogilla).

Anëtarët (F) e kuvendit të komunës së Kllokotit që kanë performuar më së miri gjatë kësaj periudhe janë: Dragana Jeremic (L.Serbe) me 7 pikë dhe Mirjana Spasic (L.Serbe) me 5 pikë nga 100 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për të gjithë indikatorët.

